RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

PARASHTRUES I KËRKESËS DHE INVESTITOR: "HAPPY CHICKEN" SH.P.K.

TITULLI I PROJEKTIT: "Ferma për rritjen e shpezëve, therjen e pulave dhe prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve"

NGASTRAT KADASTRALE: P-71813037-00183-0; P-71813037-00184-0 dhe P-71813084-00190-0

ZONA KADASTRALE: Korishë dhe Shpenadi

KOMUNA: PRIZREN

Gusht, 2026

Aplikuesi:	Hartuesi i raportit:
"HAPPY CHICKEN" SH.P.K.	**Dr.sc. Edona Kabashi - Kastrati**
Pronar z. Naim Ukaj	Eksperte e licencuar për VNM
	Nr. Licencës së lëshuar nga MMPH:
	70/17
Adresa:	
Veternik, Lagjia Qendresa, P.N.	Adresa:
Tel.: +383 49 356 427	Rr. Holger Petersen p.n.
+383 48 156 555	Lagja Prishtina e Re
E-mail: info@happychickenkosova.com	Prishtinë, Kosovë
	Tel.: +383 49 655 661
	E-mail: edonak88@gmail.com
Aplikues i projektit:	Hartuesi i Raportit:
z. Naim Ukaj, Drejtor	**Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati**
v.v.	v.v

Dhjetor, 2025

Përmbajtja:

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME 8
1.1. Të dhënat për aplikuesin 8
1.2. Të dhëna për hartuesit e Raportit të VNM-së 8
1.3. Të dhënat kryesore për projektin 9
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR 10
2.1. Kategoria e projektit të propozuar 11
2.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit 12
2.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit 12
2.4. Përshkrimi i detajuar i procesit të planifikimit dhe prodhimit 13
2.4.1. Çelja dhe rritja e shpezëve 13
2.4.2. Furnizimi dhe ruajtja e ushqimit 14
2.4.3. Përgatitja dhe transporti i shpezëve për therje 15
2.4.4. Procesi i therjes 15
2.4.5. Përpunimi dhe prodhimi i produkteve të mishit 15
2.4.6. Pastrimi dhe dezinfektimi 15
2.5. Lloji dhe sasia e burimeve të nevojshme 17
2.5.1. Sipërfaqja e tokës 17
2.5.2. Lënda e parë 17
2.5.3. Energjia elektrike 17
2.5.4. Uji 18
2.5.5. Materialet ndihmëse 19
2.5.6. Burimet njerëzore 19
2.5.7. Burimet financiare dhe teknike 20
2.6. Gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik 20
2.6.1. Mbetjet nga fermat 20
2.6.2. Mbetjet nga thertorja 20
2.6.3. Ujërat e ndotura 21
2.6.4. Emetimet në ajër 22
2.6.5. Zhurma 22
2.7. Teknologjia e trajtimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbeturinave 23
2.8. Programi i ndërtimit, funksionimit dhe rehabilitimit 23
2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme 24
2.10. Aktivitetet shtesë për zbatimin e projektit 25
2.11. Lejet dhe licencat e nevojshme 26
2.12. Ndërlidhjet e projektit me projekte të tjera 26
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR 26
3.1. Emri i lokacionit ku propozohet të zbatohet projekti 26
3.2. Pozita gjeografike, skica dhe planimetria e lokacionit 26
3.3. Distanca nga qendrat e banuara dhe objektet përreth 33
3.4. Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike 34
3.5. Burimi i furnizimit me ujë 37
3.6. Karakteristikat klimatike 37
3.7. Karakteristikat natyrore (flora dhe fauna) 38
3.8. Karakteristikat e peizazhit dhe efektet vizuale 38
3.9. Trashëgimia kulturore dhe historike 39
3.10. Popullsia dhe karakteristikat demografike 39
3.11. Objektet ekzistuese 40

3.12. Zona të ndjeshme, kërkime shkencore dhe zona me qëllime të veçanta 40
4. GJENDJA EKZISTUESE E MJEDISIT 41
4.1. Degradimi i mjedisit 41
4.2. Cilësia e ajrit 41
4.3. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore 42
4.4. Toka dhe përdorimi i saj 42
5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT 43
5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme 43
5.2. Arsyet kryesore për zgjedhjen e alternativës së caktuar 43
5.3. Vendndodhja ose rruga 44
5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut 44
5.5. Proceset dhe teknologjia e prodhimit 45
5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit 45
5.7. Plani i lokacionit 45
5.8. Lloji dhe përzgjedhja e materialeve për realizimin e projektit 45
5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit 46
5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit 46
5.11. Vëllimi i prodhimit 46
5.12. Kontrolli i ndotjes 46
5.13. Trajtimi i mbeturinave 46
5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes 47
5.15. Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit 47
5.16. Trajnimet 47
5.17. Monitorimi 47
5.18. Planet për situata emergjente 47
5.19. Demolimi dhe rehabilitimi 48
5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit 48
5.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim 48
6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS 48
6.1. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis 48
6.2. Cilësia e ajrit 49
6.3. Ndikimi i projektit në klimë 49
6.5. Mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit 50
6.6. Cilësia e ujit 50
6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore 50
6.8. Mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave 50
6.9. Ndryshimet hidromorfologjike 51
6.10. Toka 51
6.11. Ndikimi fizik dhe topografia 51
6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në tokë 51
6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore 51

6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur 52
6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike 52
6.16. Ndikimi në popullsinë lokale 52
6.17. Ndikimi në shëndetin e popullsisë 52
6.18. Rreziku nga aksidentet dhe situatat emergjente 53
6.19. Ndikimi psikologjik dhe social 53
6.24. Ndikimi në ekosistemet lokale 53
6.25. Ruajtja e biodiversitetit 54
6.26. Ndikimi në strukturën gjeologjike dhe gjeomorfologjike 54
6.27–6.29. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve 54
6.30–6.33. Infrastruktura komunale 54
6.34–6.35. Ujërat e zeza dhe gjenerimi i mbeturinave 55
6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore dhe kulturore 56
7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS 56
7.1. Masat e parashikuara me legjislacion 56
7.1.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër 57
7.1.2. Masat për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore 57
7.1.3. Masat për menaxhimin e mbetjeve dhe nënprodukteve të thertores 58
7.1.4. Masat për menaxhimin e plehut të shpezëve 59
7.1.5. Masat për mbrojtjen e tokës 59
7.1.6. Masat për mbrojtjen e ujërave nga aktiviteti i thertores 60
7.1.7. Masat për zvogëlimin e zhurmës 60
7.1.8. Masat për mbrojtjen e florës, faunës dhe biodiversitetit 60
7.1.9. Masat për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe popullsisë 61
7.1.10. Masat për menaxhimin e aromave 61
7.1.11. Masat për mbrojtjen nga zjarri dhe situatat emergjente 61
7.1.12. Masat për mbrojtjen e Lumit Toplluga 62
7.1.13. Masat për përdorimin racional të ujit 62
7.1.14. Masat për monitorimin e ndikimeve në mjedis 63
7.1.15. Përgjegjësia për zbatimin e masave mjedisore 63
8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS 64
8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis 64
8.2. Gjendja mjedisore para fillimit të aktiviteteve të projektit 64
8.3. Parametrat për përcaktimin e efektit të dëmshëm 65
8.4. Vendndodhjet, mënyra dhe shpeshtësia e matjeve 65
8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve 66
8.6. Detyrimi për të informuar publikun 67
8.7. Programi ndërkufitar i monitorimit të ndikimit në mjedis 67
9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR 68
9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit 68
9.2. Pajtueshmëria me Pëlqimin Mjedisor 69
9.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me ISO 14000 70
10. KONKLUZIONE 70

11. BURIMET E TË DHËNAVE - LITERATURA 72
12. SHTOJCA 72
PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE E RAPORTIT TË VNM-së 73

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

1.1. Të dhënat për aplikuesin

Aplikues i projektit është kompania "HAPPY CHICKEN" SH.P.K., me seli në Prizren. Kompania ushtron veprimtarinë e saj në fushën e rritjes së shpezëve, therjes së pulave dhe prodhimit të produkteve të mishit të shpezëve (pulave).

Aktiviteti zhvillohet në objektet ekzistuese të kompanisë, të cilat janë të ndërtuara dhe funksionale për zhvillimin e veprimtarisë së paraparë. Operimi i aktivitetit synon të zhvillohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e ujërave, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, planifikimin hapësinor dhe ndërtimin, si dhe me kërkesat e tjera ligjore dhe administrative që lidhen me këtë veprimtari.

Përfaqësuesi i autorizuar i kompanisë dhe aplikuesi i projektit është z. Naim Ukaj, Drejtor i kompanisë, i cili përfaqëson subjektin në procedurat administrative për pajisjen me Pëlqim Mjedisor, si dhe në procedurat e tjera përkatëse të parapara me legjislacionin në fuqi.

1.2. Të dhëna për hartuesit e Raportit të VNM-së

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është hartuar nga Dr.sc. Edona Kabashi Kastrati, eksperte e licencuar për hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, me Licencë Nr. 70/17, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

Raporti është përgatitur në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Republikës së Kosovës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, duke u bazuar në:

- dokumentacionin teknik të projektit;
- vizitën në terren dhe vlerësimin e karakteristikave të lokacionit;
- të dhënat ekzistuese mbi gjendjen e mjedisit;
- literaturën shkencore dhe teknike;
- standardet dhe praktikat ndërkombëtare për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Metodologjia e përdorur mundëson identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e ndikimeve potenciale në mjedis gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe, nëse është e aplikueshme, mbylljes së aktivitetit.

1.3. Të dhënat kryesore për projektin

Projekti për të cilin është përgatitur ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshin zhvillimin dhe funksionimin e aktivitetit për rritjen e shpezëve, therjen e pulave dhe prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve (pulave), në pronësi të kompanisë "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. Aktiviteti zhvillohet në ngastrat kadastrale: P-71813037-00183-0, Zona Kadastrale Korishë, me sipërfaqe 10,423 m²; P-71813037-00184-0, Zona Kadastrale Korishë, me sipërfaqe 3,117.9 m²; P-71813084-00190-0, Zona Kadastrale Shpenadi, me sipërfaqe 14,128 m².

Ngastrat ndodhen në lokacionet e njohura si "Kiselica-Kiselica" dhe "Brdovo Grobilje", në territorin e Komunës së Prizrenit.

Aktiviteti i kompanisë përfshin ciklin e mbarështimit dhe rritjes së shpezëve, si dhe proceset e therjes dhe përpunimit të pulave, me qëllim të prodhimit të produkteve të mishit të shpezëve të destinuara për treg.

Në kuadër të aktivitetit zhvillohen proceset teknologjike që lidhen me pranimin dhe rritjen e zogjve, ushqimin dhe mbarështimin e tyre, përgatitjen për therje, therjen, përpunimin dhe trajtimin e karkasave, përgatitjen e produkteve të mishit, paketimin, ruajtjen në kushte të kontrolluara dhe shpërndarjen e produkteve në treg.

Objektet ekzistuese disponojnë hapësirat prodhuese, hapësirat për rritjen dhe mbajtjen e shpezëve, hapësirat e therjes dhe përpunimit, magazinat, hapësirat frigoriferike dhe objektet ndihmëse, si dhe infrastrukturën përcjellëse të nevojshme për funksionimin e aktivitetit.

Infrastruktura ekzistuese përfshin, ndër të tjera, furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ujë, sistemin e kanalizimit, sistemet e ventilimit, hapësirat për menaxhimin e mbetjeve dhe qasjen rrugore, ndërsa mënyra e funksionimit dhe kapacitetet e secilit sistem do të përshkruhen në kapitujt përkatës të këtij Raporti.

Duke qenë se aktiviteti është në funksion, në kuadër të këtij Raporti do të analizohet gjendja ekzistuese e aktivitetit dhe ndikimet mjedisore që mund të shkaktohen gjatë operimit, duke përfshirë emetimet në ajër, erërat, ujërat e ndotura, mbetjet organike dhe mbetjet e tjera, zhurmën, konsumin e ujit dhe energjisë, si dhe ndikimet potenciale në tokë, ujëra dhe komponentët e tjerë të mjedisit.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

Projekti për të cilin hartohet ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) përfshin aktivitetin e rritjes së shpezëve, therjes së pulave dhe prodhimit të produkteve të mishit të shpezëve, i cili zhvillohet nga kompania "HAPPY CHICKEN" SH.P.K., në territorin e Komunës së Prizrenit.

Aktiviteti zhvillohet në parcelat kadastrale P-71813037-00183-0, P-71813037-00184-0 dhe P-71813084-00190-0, në Zonat Kadastrale Korishë dhe Shpenadi, me sipërfaqe totale prej 27,668.9 m^2.

Në kuadër të kompleksit janë të ndërtuara dhe funksionale gjashtë objekte për çeljen dhe rritjen e pulave, një objekt për therjen dhe përpunimin e shpezëve, si dhe hapësira dhe objekte përcjellëse, përfshirë silosët për ruajtjen e ushqimit, magazinat, hapësirat teknike, rrugët dhe sipërfaqet për qarkullim, ngarkim-shkarkim dhe parkim.

Qëllimi i projektit është zhvillimi i kontrolluar i ciklit të prodhimit, nga çelja dhe rritja e shpezëve, furnizimi me ushqim dhe kujdesi për to, deri te therja, përpunimi, paketimi dhe shpërndarja e produkteve të mishit të shpezëve në treg.

Nga aspekti mjedisor, aktiviteti karakterizohet nga përdorimi i ujit, energjisë elektrike, ushqimit për shpezë dhe materialeve ndihmëse, ndërsa si rezultate të procesit krijohen produkte të gatshme për konsum dhe rrjedha të ndryshme të mbetjeve dhe ujërave të ndotura, të cilat duhet të menaxhohen në përputhje me kërkesat ligjore.

Ligjet

- Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat;
- Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja;
- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;
- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;
- Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtimin;
- Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
- Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma;
- Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtjen nga Zjarri;

- Ligji Nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikatet (në rast të përdorimit ose magazinimit të substancave kimike gjatë procesit teknologjik).

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis me kërkesat ligjore dhe aspektet teknike;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupat ujorë;
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat për eliminimin e pasojave (nëse aktiviteti përfshin substanca ose preparate kimike të rrezikshme).

2.1. Kategoria e projektit të propozuar

Projekti përfshin një aktivitet agro-industrial që përfshin rritjen intensive të shpezëve, therjen e pulave dhe përpunimin e produkteve të mishit të shpezëve.

Për nga karakteri i aktivitetit, projekti përfshin disa procese të ndërlidhura:

- çeljen dhe rritjen e shpezëve;
- mbajtjen dhe ushqimin e pulave;
- furnizimin dhe ruajtjen e ushqimit;
- transportin e shpezëve për në thertore;
- therjen dhe përpunimin fillestar;
- heqjen e puplave dhe pastrimin e karkasave;
- përpunimin dhe përgatitjen e produkteve të mishit;
- paketimin dhe ruajtjen e produkteve;
- shpërndarjen e produkteve të gatshme.

Për shkak të natyrës së aktivitetit dhe mundësisë së krijimit të ndikimeve në ajër, ujë, tokë dhe mjedisin përreth, aktiviteti i nënshtrohet kërkesave të legjislacionit mjedisor të Republikës së Kosovës dhe procedurave përkatëse për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
Kategorizimi përfundimtar i projektit dhe kërkesat përkatëse administrative përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi dhe kapaciteteve reale të aktivitetit.

2.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Meqenëse objektet e projektit janë të ndërtuara dhe aktiviteti është në funksionim, nuk parashihet realizimi i punëve të reja ndërtimore për fillimin e aktivitetit të përshkruar në këtë Raport.
Punët përgatitore dhe ndërhyrjet eventuale lidhen kryesisht me:

- mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese;
- mirëmbajtjen e fermave dhe hapësirave të thertores;
- kontrollin dhe mirëmbajtjen e instalimeve elektrike;
- kontrollin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë;
- mirëmbajtjen e puseve vetjake;
- mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit;
- mirëmbajtjen e sistemeve të ventilimit;
- kontrollin dhe mirëmbajtjen e silosëve;
- mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike;
- mirëmbajtjen e rrugëve dhe sipërfaqeve të brendshme të kompleksit;
- sigurimin e hapësirave të përshtatshme për grumbullimin e mbetjeve;
- vendosjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve për mbrojtjen nga zjarri dhe situatat emergjente.

Në rast të zgjerimit ose ndryshimit të kapaciteteve ekzistuese, punët përgatitore dhe kërkesat përkatëse do të përcaktohen në përputhje me dokumentacionin teknik dhe kërkesat ligjore.

2.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Aktiviteti zhvillohet në mënyrë të integruar dhe përfshin fazat e mëposhtme:

1. Çelja dhe pranimi i zogjve

Zogjtë vendosen në objektet përkatëse dhe sigurohen kushtet e nevojshme për zhvillimin e tyre.

2. Rritja e pulave

Pulave u sigurohet ushqim, ujë, ventilim dhe kushte të përshtatshme të temperaturës dhe higjienës.

3. Furnizimi dhe ruajtja e ushqimit

Ushqimi për shpezët furnizohet dhe ruhet në silosët e ndërtuar në kuadër të kompleksit. Nga silosët ushqimi shpërndahet në sistemet ushqyese të fermave.

4. Përgatitja për therje

Pas arritjes së peshës dhe moshës së përshtatshme, pulat transportohen në mënyrë të kontrolluar drejt thertores.

5. Therja dhe përpunimi

Në thertore kryhen proceset e therjes, gjakderdhjes, heqjes së puplave, pastrimit dhe përpunimit të karkasave.

6. Përpunimi dhe paketimi

Karkasat dhe produktet e mishit përpunohen, ndahen sipas kategorive, paketohen dhe përgatiten për ruajtje dhe shpërndarje.

7. Ruajtja dhe shpërndarja

Produktet e gatshme ruhen në kushte të përshtatshme dhe më pas transportohen për në treg.

Gjatë të gjitha këtyre fazave kryhen aktivitete ndihmëse, si pastrimi dhe dezinfektimi i hapësirave, mirëmbajtja e pajisjeve, menaxhimi i ujit dhe energjisë dhe menaxhimi i mbetjeve.

2.4. Përshkrimi i detajuar i procesit të planifikimit dhe prodhimit

Procesi teknologjik i aktivitetit fillon me çeljen dhe rritjen e shpezëve, vazhdon me përgatitjen për therje dhe përfundon me prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të mishit të shpezëve.

2.4.1. Çelja dhe rritja e shpezëve

Zogjtë vendosen në objektet e fermave, ku u sigurohen kushtet e nevojshme për rritje. Procesi përfshin:

- furnizimin me ushqim;
- furnizimin me ujë;
- ventilimin;
- kontrollin e temperaturës;
- pastrimin dhe dezinfektimin;
- kontrollin veterinar;
- menaxhimin e plehut të shpezëve.

2.4.2. Furnizimi dhe ruajtja e ushqimit

Ushqimi ruhet në silosët e kompleksit, të cilët shërbejnë për ruajtjen dhe furnizimin e vazhdueshëm të fermave.

Nga silosët, ushqimi përcillet përmes sistemeve përkatëse deri te pajisjet ushqyese brenda fermave. Për mirëmbajtjen e cilësisë së ushqimit duhet të parandalohet depërtimi i lagështisë dhe kontaminimi i tij.



2.4.3. Përgatitja dhe transporti i shpezëve për therje

Pas përfundimit të ciklit të rritjes, shpezët përgatiten dhe transportohen drejt thertores. Transporti duhet të realizohet në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat veterinare dhe të mirëqenies së kafshëve.

2.4.4. Procesi i therjes

Procesi i therjes përfshin, në varësi të pajisjeve dhe teknologjisë së përdorur:

- pranimin e shpezëve;
- therjen;
- gjakderdhjen;
- përvëlimin;
- heqjen e puplave;
- pastrimin;
- heqjen e pjesëve të brendshme;
- larjen dhe përpunimin e karkasës;
- ftohjen;
- ndarjen dhe përpunimin e produkteve.

Gjatë këtij procesi krijohen nënprodukte dhe mbetje organike, ndër të cilat gjaku, puplat, pjesët e papërdorshme të trupit, indet, yndyrnat dhe materiale të tjera organike.

Këto mbetje duhet të mblidhen në mënyrë të kontrolluar dhe të mos lejohen të përfundojnë në kanalizim, tokë ose ujëra sipërfaqësore.

2.4.5. Përpunimi dhe prodhimi i produkteve të mishit

Pas therjes dhe përpunimit fillestar, mishi përgatitet për prodhim dhe tregtim. Procesi mund të përfshijë ndarjen, prerjen, përpunimin, paketimin dhe ruajtjen në kushte të përshtatshme higjienike dhe termike.

2.4.6. Pastrimi dhe dezinfektimi

Pas përfundimit të proceseve prodhuese, hapësirat dhe pajisjet pastrohen dhe dezinfektohen.

Ky proces krijon ujëra të ndotura që mund të përmbajnë materie organike, yndyrna, detergjentë dhe dezinfektues, prandaj ato duhet të menaxhohen përmes sistemit përkatës të kanalizimit dhe në përputhje me kërkesat mjedisore.





2.5. Lloji dhe sasia e burimeve të nevojshme

2.5.1. Sipërfaqja e tokës

Aktiviteti zhvillohet në tri parcela kadastrale me sipërfaqe:

- P-71813037-00183-0 – 10,423 m²;
- P-71813037-00184-0 – 3,117.9 m²;
- P-71813084-00190-0 – 14,128 m².

Sipërfaqja totale e lokacionit është 27,668.9 m².

2.5.2. Lënda e parë

Burimet kryesore materiale janë:

- zogjtë për rritje;
- ushqimi për shpezë;
- uji;
- materialet për paketim;
- materialet dhe produktet për pastrim e dezinfektim;
- materialet ndihmëse për mirëmbajtje;
- materialet e nevojshme për procesin e përpunimit dhe ruajtjes së produkteve.

Sasia e këtyre materialeve ndryshon në varësi të kapacitetit dhe ciklit të prodhimit.

2.5.3. Energjia elektrike

Energjia elektrike përdoret për:

- ndriçimin;
- ventilimin;
- pajisjet e fermave;
- sistemet e ushqimit dhe furnizimit me ujë;
- pajisjet e thertores;
- pajisjet e përpunimit;
- sistemet e ftohjes dhe ruajtjes;
- pajisjet ndihmëse dhe administrative.

Furnizimi bëhet përmes rrjetit ekzistues elektrik të trafos personale dhe gjeneratorit.



2.5.4. Uji

Uji për nevojat e aktivitetit sigurohet përmes puseve vetjake të hapura në lokacion.

Uji përdoret për:

- pirjen dhe rritjen e shpezëve;
- proceset e therjes dhe përpunimit;
- larjen e pajisjeve dhe hapësirave;
- pastrimin dhe dezinfektimin;
- nevojat sanitare të punëtorëve;
- nevoja të tjera teknologjike.

Konsumi i ujit varet nga numri i shpezëve, kapaciteti i thertores dhe intensiteti i aktivitetit.

2.5.5. Materialet ndihmëse

Materialet ndihmëse përfshijnë:

- detergjentë dhe dezinfektues;
- materiale për paketim;
- pajisje dhe materiale për mirëmbajtje;
- vajra dhe lubrifikantë për pajisjet;
- pajisje mbrojtëse personale;
- materiale sanitare dhe higjienike.

2.5.6. Burimet njerëzore

Aktiviteti kërkon personel për:

- menaxhimin e fermave;
- kujdesin dhe ushqimin e shpezëve;
- funksionimin e thertores;
- përpunimin dhe paketimin;
- mirëmbajtjen;
- pastrimin dhe dezinfektimin;
- transportin dhe magazinimin;
- administrimin dhe menaxhimin.

Numri i saktë i punëtorëve përcaktohet sipas organizimit dhe sezones, aktualisht rreth 30 punëtor.

2.5.7. Burimet financiare dhe teknike

Burimet financiare sigurohen nga operatori për funksionimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aktivitetit.

Burimet teknike përfshijnë objektet e fermave, thertoren, silosët, pajisjet teknologjike, sistemet e ventilimit, sistemet e furnizimit me ujë, kanalizimin, pajisjet e ftohjes dhe pajisjet e tjera ndihmëse.

2.6. Gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik

Gjatë funksionimit të aktivitetit krijohen mbetje dhe emetime të ndryshme.

2.6.1. Mbetjet nga fermat

Nga fermat krijohen kryesisht:

- plehu i shpezëve;
- mbetje ushqimore;
- materiale të përdorura për mirëmbajtje dhe pastrim;
- mbetje komunale nga aktiviteti i punëtorëve.

2.6.2. Mbetjet nga thertorja

Mbetjet kryesore të procesit të therjes janë:

- gjaku;
- puplat;
- pjesët dhe indet organike që nuk përdoren;
- përmbajtjet e traktit gastrointestinal;
- yndyrnat;
- mbetjet e tjera organike;
- materialet e paketimit dhe mbetjet e tjera ndihmëse.

Këto paraqesin burimin kryesor potencial të ngarkesës organike dhe aromave dhe duhet të menaxhohen në mënyrë të kontrolluar.



2.6.3. Ujërat e ndotura

Ujërat e ndotura krijohen nga:

- pastrimi i fermave;
- procesi i therjes;
- larja e pajisjeve;
- pastrimi dhe dezinfektimi;
- objektet sanitare.

Ujërat mund të përmbajnë ngarkesë të shtuar organike, yndyrna, detergjentë, dezinfektues dhe materiale të imta, prandaj gjithnjë duhet të trajtohen para se te shkarkohen në rrejtin e kanalizimit.

2.6.4. Emetimet në ajër

Burimet kryesore potenciale janë:

- aromat nga fermat;
- aromat nga mbetjet organike të thertores;
- pluhuri nga ushqimi dhe silosët;
- emetimet nga ventilimi;
- emetimet nga automjetet.

2.6.5. Zhurma

Zhurma krijohet kryesisht nga:

- pajisjet e fermave;
- ventilatorët;
- pajisjet e thertores;
- kompresorët dhe pajisjet e ftohjes;
- automjetet dhe aktivitetet e ngarkim-shkarkimit.

2.7. Teknologjia e trajtimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbeturinave

Menaxhimi i mbetjeve bëhet në bazë të parimit të ndarjes, grumbullimit, ruajtjes së përkohshme dhe destinimit të kontrolluar.

Mbetjet nga aktiviteti duhet të ndahen sipas llojit dhe karakteristikave të tyre.

Mbetjet organike nga thertorja

Gjaku, puplat, indet, yndyrnat dhe mbetjet e tjera organike grumbullohen në enë ose hapësira të përshtatshme dhe të mbrojtura.

Ato nuk duhet të:

- hidhen në kanalizim;
- depozitohen në tokë;
- hidhen në lumin Toplluqa;
- digjen në mënyrë të pakontrolluar;
- lihen për periudha të gjata në ambient të hapur.

Largimi dhe destinimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe, kur kërkohet, përmes operatorëve të autorizuar.

Plehu i shpezëve

Plehu duhet të mblidhet dhe të ruhet në mënyrë që të parandalohet rrjedhja e lëngjeve dhe kontakti me tokën dhe ujërat.

Mbetjet komunale

Mbetjet komunale ndahen dhe grumbullohen në kontejnerë të përshtatshëm dhe dorëzohen përmes sistemit të autorizuar të menaxhimit të mbeturinave.

Mbetjet e vajrave dhe substancave kimike

Vajrat e përdorur, ambalazhet e kontaminuara, detergjentët dhe materialet e tjera të rrezikshme, nëse krijohen, duhet të ruhen veçmas dhe të dorëzohen te operatorë të autorizuar sipas kërkesave ligjore.

2.8. Programi i ndërtimit, funksionimit dhe rehabilitimit

Meqenëse objekti dhe infrastruktura kryesore e projektit janë tashmë të ndërtuara dhe në funksionim, nuk parashihet një fazë e re ndërtimore për realizimin e aktivitetit aktual.

Faza e ndërtimit

Faza e ndërtimit ka përfunduar. Objektet ekzistuese përfshijnë fermat, thertoren, silosët dhe hapësirat përcjellëse.

Faza e funksionimit

Faza aktuale është funksionimi i:

- gjashtë fermave për çeljen dhe rritjen e pulave;
- thertores;
- njësive të përpunimit;
- silosëve;
- magazinave dhe hapësirave përcjellëse.

Funksionimi duhet të zhvillohet në përputhje me kërkesat mjedisore, higjieno-sanitare dhe teknike.

Faza e rehabilitimit

Në rast të ndërprerjes përfundimtare të aktivitetit, operatori duhet të hartojë dhe zbatojë masa për:

- largimin e pajisjeve;
- largimin e mbetjeve dhe materialeve;
- pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve;
- pastrimin e sistemeve të kanalizimit;
- kontrollin e tokës dhe sipërfaqeve;
- rehabilitimin e sipërfaqeve që mund të jenë dëmtuar ose ndotur.

Çdo aktivitet i ardhshëm për zgjerim, ndryshim të kapacitetit ose rehabilitim të rëndësishëm duhet të trajtohet sipas kërkesave ligjore që zbatohen në atë kohë.

2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Kompleksi i kompanisë "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. disponon infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit.

Qasja rrugore

Lokacioni ka qasje përmes rrugës sekondare e cila lidhet me rrugën magjistrale Prizren–Suharekë. Kjo mundëson transportin e shpezëve, ushqimit, materialeve dhe produkteve të gatshme.

Furnizimi me ujë

Furnizimi sigurohet përmes puseve vetjake të hapura në lokacion.

Furnizimi me energji

Kompleksi furnizohet me energji elektrike përmes rrjetit ekzistues.

Kanalizimi

Objektet janë të pajisura me sistem të kanalizimit për mbledhjen dhe largimin e ujërave të përdorura nga proceset teknologjike dhe sanitare. Kompania posedon system për trajtimin e mbetjeve të gjakut dhe puplave para se ato ti shkarkoj.

Sistemi duhet të kontrollohet dhe mirëmbahet rregullisht për të parandaluar rrjedhjet dhe shkarkimet e pakontrolluara.

Ventilimi

Objektet e fermave dhe thertorja disponojnë sisteme ventilimi për sigurimin e kushteve të përshtatshme të funksionimit dhe kontrollin e temperaturës dhe cilësisë së ajrit në hapësirat e punës.

Silosët dhe magazinat

Në kuadër të kompleksit janë të ndërtuara silosë për ruajtjen e ushqimit për shpezët, si dhe hapësira magazinimi për materialet dhe produktet e nevojshme për funksionimin e aktivitetit.

Infrastrukturë tjetër përcjellëse

Kompleksi përfshin gjithashtu:

- hapësira për ngarkim dhe shkarkim;
- parkingje;
- sipërfaqe për qarkullimin e automjeteve;
- hapësira të gjelbra;
- hapësira për grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve;
- pajisje për mbrojtje nga zjarri;
- hapësira administrative dhe sanitare.

2.10. Aktivitetet shtesë për zbatimin e projektit

Për realizimin dhe funksionimin e projektit të "HAPPY CHICKEN" SH.P.K., përveç aktiviteteve kryesore të rritjes së shpezëve, therjes së pulave dhe prodhimit të produkteve të mishit të shpezëve, zhvillohen edhe një sërë aktivitetesh ndihmëse dhe përcjellëse, të cilat janë të nevojshme për funksionimin normal, higjienik dhe të sigurt të kompleksit.

Duke pasur parasysh se objektet janë tashmë të ndërtuara dhe aktiviteti është në funksion, aktivitetet shtesë lidhen kryesisht me furnizimin, mirëmbajtjen, higjienën, transportin, menaxhimin e mbetjeve, kontrollin veterinar dhe mjedisor, si dhe sigurimin e funksionimit të pandërprerë të infrastrukturës përcjellëse.

2.11. Lejet dhe licencat e nevojshme

Për zbatimin e aktivitetit të thertorës kërkohen:

- Pelqim Mjedisor;
- Leja mjedisore;
- Leje Ujore;
- Lejet dhe licencat veterinare dhe ushqimore;
- Pëlqime/njoftime nga autoritetet kompetente (komuna).

2.12. Ndërlidhjet e projektit me projekte të tjera

Projekti nuk paraqet ndërlidhje direkte apo kumulative me projekte të tjera ekzistuese që do të rezultonin në ndikime shtesë të rëndësishme mjedisore.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

3.1. Emri i lokacionit ku propozohet të zbatohet projekti

Kompania "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. zhvillon aktivitetin në parcelat kadastrale P-71813037-00183-0, Zona Kadastrale Korishë, me sipërfaqe 10,423 m²; P-71813037-00184-0, Zona Kadastrale Korishë, me sipërfaqe 3,117.9 m²; dhe P-71813084-00190-0, Zona Kadastrale Shpenadi, me sipërfaqe 14,128 m².

Ngastrat ndodhen në lokacionet e njohura si "Kiselica-Kiselica" dhe "Brdovo Grobilje", në territorin administrativ të Komunës së Prizrenit.

3.2. Pozita gjeografike, skica dhe planimetria e lokacionit

Lokacioni ku zhvillohet aktiviteti i rritjes së shpezëve, therjes së pulave dhe prodhimit të produkteve të mishit të shpezëve përfshin parcelat kadastrale P-71813037-00183-0, Zona Kadastrale Korishë, me sipërfaqe 10,423 m²; P-71813037-00184-0, Zona Kadastrale Korishë, me sipërfaqe 3,117.9 m²; dhe P-71813084-00190-0, Zona Kadastrale Shpenadi, me sipërfaqe 14,128 m².

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave të përfshira në aktivitet është 27,668.9 m². Parcelat kanë konfiguracion të parregullt gjeometrik.

Të dhënat mbi parcelat, sipërfaqen, pronësinë dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre janë të evidentuara në Fletën Poseduese dhe Kopjen e Planit, të lëshuara nga Drejtoria për Gjeodezi dhe

Kadastër, me nr. të lëndës 07-029-4308-26, datë 28.05.2026, në Zyrën Kadastrale të Prizrenit, Komuna e Prizrenit.

Sipas të dhënave të Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK), lokacioni i projektit ndodhet në Zonën Bujqësore (ZB).

Në kuadër të shfrytëzimeve të veçanta të kësaj zone parashihet edhe infrastruktura dhe ndërtesat mbështetëse në funksion të prodhimtarisë blegtorale, përfshirë fermat e mesme dhe të mëdha për mbarështimin e kafshëve dhe shpezëve, ndërtesat e tyre përcjellëse, ndërtesat për ruajtjen e ushqimit për bagëti, si dhe hapësirat për përpunimin e produkteve blegtorale.

Ky përcaktim është i rëndësishëm për vlerësimin e përputhshmërisë së përdorimit ekzistues të lokacionit me dokumentet përkatëse të planifikimit hapësinor.

E drejta pronësore mbi parcelat është e evidentuar në emër të pronarëve z. Selim Ukaj dhe z. Agim Ukaj, nga Korisha e Prizrenit.

Shfrytëzues i lokacionit dhe operator i aktivitetit është kompania "HAPPY CHICKEN" SH.P.K., e cila e shfrytëzon lokacionin në bazë të marrëdhënies kontraktuale të qirasë.

Lokacioni ndodhet në anën e majtë të rrugës magjistrale Prizren–Suharekë, në një distancë prej rreth 3 km nga qyteti i Prizrenit.

Pozita e lokacionit është e favorshme për zhvillimin e aktivitetit, veçanërisht për shkak të qasjes në rrjetin ekzistues rrugor dhe lidhjes me infrastrukturën teknike të nevojshme për funksionimin e kompleksit.

Qasja në lokacion realizohet përmes një rruge sekondare, e cila lidhet me rrugën magjistrale Prizren–Suharekë. Përmes rrjetit ekzistues rrugor mundësohet lidhja me drejtimet Prizren–Gjakovë dhe me Autostradën "Ibrahim Rugova", duke krijuar kushte të përshtatshme për transportin e lëndëve të para, lëvizjen e automjeteve dhe shpërndarjen e produkteve të gatshme në treg.

Në lokacion janë të ndërtuara fermat e kompanisë për rritjen e shpezëve, therjen e pulave dhe prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve, së bashku me hapësirat dhe infrastrukturën përcjellëse të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit.

Në kuadër të kompleksit janë të organizuara hapësirat për zhvillimin e proceseve teknologjike, qarkullimin e automjeteve, furnizimin me lëndë të para, ngarkimin dhe shkarkimin e produkteve, si dhe grumbullimin dhe menaxhimin e kontrolluar të mbetjeve.

Duke qenë se aktiviteti është ekzistues dhe objektet janë të ndërtuara, vlerësimi i ndikimeve mjedisore në këtë raport do të bazohet kryesisht në gjendjen faktike të lokacionit dhe në ndikimet që krijohen gjatë fazës së funksionimit.

Terreni i lokacionit është kryesisht i rrafshët, ndërsa konfiguracioni i parcelave dhe karakteristikat topografike të terrenit mundësojnë funksionimin e objekteve dhe infrastrukturës përcjellëse pa pasur nevojë për ndërhyrje të rëndësishme në konfiguracionin ekzistues të terrenit.

Gjendja relativisht e rrafshët e lokacionit është e përshtatshme për qarkullimin e automjeteve, furnizimin e objekteve, proceset e ngarkim-shkarkimit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës.

Sipas të dhënave kadastrale, parcelat e përfshira në lokacion figurojnë si tokë bujqësore, me mënyrë shfrytëzimi "arë", të klasifikuara në klasën 5 dhe 6.

Megjithatë, në aspektin faktik, sipërfaqja e lokacionit është e shfrytëzuar për zhvillimin e aktivitetit ekzistues, ku janë të ndërtuara objektet dhe infrastruktura përcjellëse e kompanisë.

Për këtë arsye, në vlerësimin mjedisor duhet të merret parasysh dallimi ndërmjet kategorisë kadastrale të tokës dhe shfrytëzimit faktik ekzistues të sipërfaqes.

Bazuar në gjendjen e evidentuar në terren dhe karakteristikat e zonës përreth, në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit nuk janë evidentuar aktivitete të tjera të rëndësishme ekonomike ose shërbime që mund të paraqesin konflikt të drejtpërdrejtë me funksionimin e aktivitetit të "HAPPY CHICKEN" SH.P.K.

Karakteri i zonës, qasja në rrjetin rrugor dhe infrastruktura ekzistuese krijojnë kushte të përshtatshme për funksionimin e aktivitetit dhe për furnizimin me lëndë të para dhe shpërndarjen e produkteve të gatshme.

Figura 1. Harta e pozitës së lokacionit të projektit në territorin e Komunës së Prizrenit



Figura 2. Kopja e planit kadastral të parcelave të përfshira në projekt



Figura 3. Planimetria/situacioni i objekteve dhe infrastrukturës ekzistuese të "HAPPY CHICKEN" SH.P.K.



Foto 4. Pamje nga terreni i fermave dhe objekteve tjera percjellwse

3.3. Distanca nga qendrat e banuara dhe objektet përreth

Lokacioni i aktivitetit të "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. ndodhet në një zonë me karakter kryesisht rural, bujqësor dhe afarist, ku nuk evidentohet përqendrim i lartë i objekteve të banimit në afërsi të drejtpërdrejtë të kompleksit.

Objektet më të afërta të banimit ndodhen në një distancë prej rreth 430 m nga parcelat ku zhvillohet aktiviteti. Ndërsa zona me përqendrim më të theksuar të banimit, përkatësisht fshati Shpenadi, ndodhet në një distancë prej rreth 900 m nga lokacioni i aktivitetit.

Duke marrë parasysh distancën nga objektet e banimit, konfiguracionin e terrenit, karakterin e zonës dhe mënyrën e organizimit të aktivitetit, lokacioni nuk ndodhet në një zonë me përqendrim të madh të receptorëve të ndjeshëm ndaj ndikimeve potenciale mjedisore.

Në zonën përreth lokacionit mbizotërojnë sipërfaqet bujqësore dhe hapësirat e përdorura për veprimtari afariste dhe ekonomike.



Figura 5. Distancat me objektet me të aferta të banimit

3.4. Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike

Zona e Korishës dhe Shpenadisë shtrihet në kuadër të Rrafshit të Prizrenit dhe karakterizohet kryesisht nga terren relativisht i rrafshët, me përdorim të kombinuar të hapësirës për qëllime bujqësore, banim dhe veprimtari ekonomike. Lokacioni i kompanisë "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. ndodhet në një zonë të karakterizuar kryesisht nga përdorimi bujqësor, ku aktiviteti ekzistues zhvillohet në objekte të ndërtuara dhe në infrastrukturën përcjellëse të kompleksit.

Karakteristikat pedologjike

Nga aspekti pedologjik, zona më e gjerë e Rrafshit të Prizrenit karakterizohet nga toka të zhvilluara mbi depozitime të reja aluviale dhe deluviale. Në varësi të kushteve lokale, këto toka mund të paraqesin përbërje të ndryshme granulometrike, duke përfshirë fraksione argjilore, ranore dhe zhavorrore.

Shtresa sipërfaqësore e tokës në lokacion është e ndikuar nga përdorimi ekzistues i parcelave, ndërtimi i objekteve dhe shtrirja e infrastrukturës përcjellëse. Për këtë arsye, karakteristikat natyrore të tokës në pjesët e zëna nga objektet dhe sipërfaqet e rregulluara janë pjesërisht të transformuara nga aktiviteti antropogjen.

Për mbrojtjen e tokës nga ndotja potenciale, gjatë funksionimit të aktivitetit duhet të sigurohet menaxhimi i kontrolluar i mbetjeve, nënprodukteve me origjinë shtazore, karburanteve, substancave për pastrim dhe dezinfektim, si dhe ujërave të ndotura.

Karakteristikat gjeomorfologjike

Nga aspekti gjeomorfologjik, lokacioni karakterizohet nga reliev kryesisht i rrafshët dhe pjerrësi e vogël, karakteristikë kjo e zonave të rrafshëta të Rrafshit të Prizrenit.

Konfiguracioni i terrenit është i përshtatshëm për funksionimin e objekteve ekzistuese dhe të infrastrukturës përcjellëse. Në kuadër të vëzhgimit të gjendjes ekzistuese të lokacionit nuk janë evidentuar procese të theksuara aktive të erozionit, rrëshqitjeve të tokës apo paqëndrueshmërisë së sipërfaqes që do të paraqisnin kufizim të drejtpërdrejtë për zhvillimin e aktivitetit ekzistues.

Megjithatë, mirëmbajtja e sipërfaqeve të jashtme, sistemeve të drenazhimit dhe kanalizimit është e rëndësishme për kontrollin e ujërave atmosferike dhe parandalimin e erozionit lokal apo dëmtimeve të sipërfaqeve të kompleksit.

Karakteristikat gjeologjike

Nga aspekti gjeologjik, zona e Rrafshit të Prizrenit karakterizohet në pjesën e saj fushore nga depozitime sedimentare të moshës së re, të cilat përfshijnë materiale të tilla si zhavorre, rëra dhe argjila, me ndryshime lokale në përbërje dhe trashësi.

Në sipërfaqet e lokacionit ku janë të ndërtuara objektet dhe infrastruktura përcjellëse, kushtet natyrore të terrenit janë pjesërisht të modifikuara si rezultat i ndërhyrjeve të mëparshme ndërtimore.

Gjatë vlerësimit të gjendjes ekzistuese të lokacionit nuk janë evidentuar dukuri të dukshme të paqëndrueshmërisë gjeologjike që do të përbënin kufizim të drejtpërdrejtë për funksionimin e objekteve ekzistuese. Për çështjet që lidhen me stabilitetin konstruktiv dhe parametrat gjeoteknikë të objekteve, vlejnë dokumentacioni teknik i ndërtimit dhe kushtet e përcaktuara në projektet përkatëse.

Karakteristikat hidrogjeologjike

Nga aspekti hidrogjeologjik, karakteristikat e zonës lidhen me depozitimet aluviale të Rrafshit të Prizrenit, të cilat, në varësi të përbërjes dhe përshkueshmërisë së shtresave, mund të krijojnë kushte për praninë dhe qarkullimin e ujërave nëntokësore.

Niveli i ujërave nëntokësore mund të ndryshojë në varësi të kushteve sezonale, reshjeve, karakteristikave të depozitimeve gjeologjike dhe kushteve lokale të drenazhimit. Për përcaktimin e saktë të nivelit, drejtimit të rrjedhjes dhe parametrave të ujërave nëntokësore nevojiten të dhëna nga matje ose studime të veçanta hidrogjeologjike.

Në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit, gjatë vëzhgimit të gjendjes ekzistuese, nuk janë evidentuar burime të rëndësishme ujore sipërfaqësore që do të mund të ndikoheshin drejtpërdrejt nga aktiviteti.

Duke pasur parasysh natyrën e aktivitetit, mbrojtja e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore është e rëndësishme, veçanërisht në raport me ujërat e ndotura, mbetjet organike, nënproduktet e therjes dhe substancat e përdorura për pastrim dhe dezinfektim. Për këtë qëllim, operatori duhet të sigurojë mbledhjen, trajtimin dhe shkarkimin e kontrolluar të ujërave të ndotura, si dhe ruajtjen dhe menaxhimin e sigurt të mbetjeve.

Karakteristikat sizmologjike

Territori i Kosovës, përfshirë rajonin e Prizrenit, është i ekspozuar ndaj aktivitetit sizmik dhe, për këtë arsye, rreziku sizmik duhet të merret në konsideratë gjatë projektimit, ndërtimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të objekteve.

Për objektet ekzistuese të kompleksit, respektimi i kërkesave teknike të ndërtimit dhe mirëmbajtja e rregullt e strukturave janë të rëndësishme për garantimin e sigurisë së tyre gjatë operimit.

Në rast të ndërhyrjeve të ardhshme ndërtimore, zgjerimeve ose ndryshimeve të rëndësishme strukturore, duhet të merren parasysh parametrat sizmikë të përcaktuar në dokumentacionin teknik dhe standardet përkatëse të projektimit.



Legjenda

J -*Jurasiku* $T_{2,3}$ - *Triasiku* $Pl_{2,3}$ -*Plioceni* al -*Aluvionet* pr -*Praluvionet*

Figura 6. Harta Gjeologjike e Regjionit të Prizrenit 1:25000

3.5. Burimi i furnizimit me ujë

Furnizimi me ujë për nevojat e kompanisë "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. sigurohet përmes puseve vetjake të hapura në lokacion, të cilat shërbejnë si burim i ujit për objektet e fermës, thertores dhe njësisë së përpunimit.

Uji i siguruar nga puset përdoret kryesisht për:

- furnizimin e shpezëve me ujë;
- procesin e therjes dhe përpunimit;
- pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve dhe pajisjeve;
- nevojat sanitare të punëtorëve;
- nevoja të tjera teknike të aktivitetit.

Puset dhe sistemi i furnizimit me ujë duhet të mirëmbahen dhe kontrollohen rregullisht, ndërsa cilësia e ujit duhet të monitorohet në përputhje me kërkesat përkatëse higjieno-sanitare, veçanërisht për shkak të përdorimit të tij në aktivitetin e prodhimit të produkteve ushqimore me origjinë shtazore.

3.6. Karakteristikat klimatike

Zona e fshatrave Korishë dhe Shpenadi, në kuadër të Komunës së Prizrenit, karakterizohet nga klimë kontinentale me ndikime të moderuara mesdhetare, me vera relativisht të nxehta dhe dimra të ftohtë.

Temperatura mesatare vjetore është rreth 12°C. Gjatë verës temperaturat mund të arrijnë mbi 30°C, ndërsa temperaturat më të ulëta paraqiten gjatë muajve të dimrit.
Reshjet mesatare vjetore janë rreth 670–820 mm, ndërsa lagështia relative mesatare vjetore sillet rreth 66–70%. Në zonë mbizotërojnë erërat me drejtim verior, me shpejtësi mesatare rreth 3 m/s. Kushtet klimatike të zonës janë përgjithësisht të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të rritjes së shpezëve, therjes së pulave dhe prodhimit të produkteve të mishit të shpezëve. Gjatë funksionimit të aktivitetit, kushtet klimatike merren parasysh veçanërisht në funksionimin e sistemeve të ventilimit, kontrollin e temperaturës dhe lagështisë në objektet e fermës dhe përpunimit, si dhe në menaxhimin e aromave dhe emetimeve të mundshme në ajër.

3.7. Karakteristikat natyrore (flora dhe fauna)

Zona e fshatrave Korishë dhe Shpenadi karakterizohet kryesisht nga mjedis rural dhe bujqësor, ku në sipërfaqet përreth lokacionit kultivohen kryesisht kultura bujqësore sezonale, si gruri, misri dhe kultura të tjera bujqësore. Në hapësirat e pa mbjella dhe në skajet e parcelave haset gjithashtu vegjetacion barishtor dhe bimësi spontane.

Fauna e zonës përfaqësohet kryesisht nga lloje të zakonshme të zonave fushore dhe agro-ekosistemeve, duke përfshirë gjitarë të vegjël, brejtës, zvarranikë dhe shpendë të zakonshëm, të cilët janë përshtatur me karakterin bujqësor të zonës.

Në lokacionin e "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. dhe në hapësirat përreth tij nuk janë evidentuar habitate të ndjeshme ekologjike, zona të mbrojtura natyrore apo lloje të rralla dhe të rrezikuara me rëndësi të veçantë për konservim.

Brenda kompleksit të kompanisë ka sipërfaqe të gjelbra të dedikuara, ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes shfrytëzohet për objektet e fermës dhe infrastrukturën përcjellëse. Sipërfaqet e shtruara me kubeza dhe rërë përdoren për parking, qarkullimin e automjeteve, ngarkim-shkarkimin dhe manipulimin e produkteve dhe materialeve.

Duke marrë parasysh karakterin bujqësor të zonës, gjendjen ekzistuese të lokacionit dhe mungesën e habitateve të veçanta me rëndësi konservuese, ndikimi i aktivitetit në florën dhe faunën lokale vlerësohet të jetë i kufizuar, me kusht që të zbatohen masat për menaxhimin e mbetjeve, ujërave të ndotura, emetimeve dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra.

3.8. Karakteristikat e peizazhit dhe efektet vizuale

Peizazhi i zonës ku ndodhet lokacioni i "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. karakterizohet kryesisht nga hapësira rurale dhe bujqësore, me parcela të mbjella me kultura sezonale, si grurë, misër dhe kultura të tjera bujqësore. Terreni është kryesisht i rrafshët dhe ndërthuret me objekte të banimit, rrugë dhe ndërtesa të karakterit ekonomik.

Lokacioni i aktivitetit është i zhvilluar dhe përmban objekte ekzistuese të fermës, thertores dhe përpunimit, si dhe hapësira përcjellëse për qarkullim, parking dhe ngarkim-shkarkim. Për shkak se aktiviteti është ekzistues, ndikimi vizual lidhet kryesisht me praninë dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe infrastrukturës ekzistuese.

Nga aspekti vizual, objektet nuk paraqesin ndryshim të rëndësishëm në karakterin e përgjithshëm të peizazhit, i cili tashmë është i ndikuar nga përdorimi bujqësor dhe aktivitetet antropogjene. Sipërfaqet e gjelbra brenda kompleksit kontribuojnë në integrimin vizual të objekteve me mjedisin përreth.

Për të ruajtur cilësinë vizuale të lokacionit, operatori duhet të sigurojë mirëmbajtjen e rregullt të objekteve, pastërtinë e hapësirave të jashtme, menaxhimin e mbetjeve dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra.

Në përgjithësi, duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese të lokacionit dhe karakterin rural-bujqësor të zonës, efekti vizual i aktivitetit vlerësohet të jetë i kufizuar dhe nuk pritet të shkaktojë ndryshime të rëndësishme në peizazhin përreth.

3.9. Trashëgimia kulturore dhe historike

Në lokacionin e projektit dhe në afërsi të drejtpërdrejtë të tij nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore ose historike, si dhe nuk janë evidentuar zona me rëndësi arkeologjike.

Në territorin më të gjerë të Komunës së Prizrenit gjenden monumente dhe zona me rëndësi kulturore, si Kalaja e Prizrenit, Ura e Gurit dhe objekte të tjera historike, të cilat ndodhen jashtë ndikimit të drejtpërdrejtë të projektit.

3.10. Popullsia dhe karakteristikat demografike

Lokacioni i aktivitetit të kompanisë "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. ndodhet në territorin e Komunës së Prizrenit, në afërsi të fshatrave Korishë dhe Shpenadi, të cilat përfaqësojnë vendbanime me karakter kryesisht rural.

Popullsia e zonës merret kryesisht me bujqësi, blegtori, tregti, veprimtari afariste dhe aktivitete të tjera ekonomike, ndërsa një pjesë e banorëve janë të punësuar në sektorin privat dhe publik në Komunën e Prizrenit dhe zonat përreth.

Objektet më të afërta të banimit ndodhen në një distancë prej rreth 430 m nga lokacioni i aktivitetit, ndërsa zona më e dendur e banimit e fshatit Shpenadi ndodhet në një distancë prej rreth 900 m. Kjo distancë kontribuon në zvogëlimin e ndikimeve të mundshme të aktivitetit në popullatën përreth.

Aktiviteti i rritjes së shpezëve, therjes së pulave dhe prodhimit të produkteve të mishit të shpezëve ka rëndësi ekonomike për zonën, pasi krijon vende pune dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik

lokal përmes angazhimit të fuqisë punëtore, bashkëpunimit me furnitorët dhe ofrimit të produkteve në treg.

Bazuar në karakteristikat ekzistuese të lokacionit, distancën nga zonat e banuara dhe masat e planifikuara për mbrojtjen e mjedisit, nuk priten ndikime të rëndësishme negative në strukturën demografike apo kushtet e jetesës së popullsisë përreth. Megjithatë, menaxhimi i duhur i aromave, mbetjeve, ujërave të ndotura dhe zhurmës mbetet i rëndësishëm për ruajtjen e cilësisë së mjedisit dhe mirëqenies së komunitetit lokal.

3.11. Objektet ekzistuese

Në ngastrat kadastrale të përfshira në lokacionin e kompanisë "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. janë të ndërtuara dhe në funksion gjashtë (6) objekte të fermave për çeljen e zogjve dhe rritjen e pulave, si dhe një (1) objekt i thertores dhe përpunimit, ku realizohet therja e pulave dhe prodhimi i produkteve të mishit të shpezëve.

Kompleksi përfshin gjithashtu silosët për ruajtjen dhe magazinimin e ushqimit të shpezëve, si dhe hapësirat dhe objektet përcjellëse të nevojshme për funksionimin e aktivitetit, përfshirë hapësirat për magazinim, manipulim të produkteve, objektet administrative dhe sanitare.

Në kuadër të kompleksit ekzistojnë edhe infrastruktura teknike dhe përcjellëse, si sistemi i furnizimit me ujë përmes puseve vetjake, furnizimi me energji elektrike, sistemi i kanalizimit, sistemet e ventilimit, rrugët e brendshme, hapësirat e parkimit dhe zonat për ngarkim-shkarkim.

Gjashtë fermat shfrytëzohen për çeljen e zogjve dhe rritjen e pulave, ndërsa pas arritjes së peshës së përshtatshme për therje, pulat dërgohen në thertoren e kompleksit, ku zhvillohen proceset e therjes, përpunimit dhe përgatitjes së produkteve të mishit të shpezëve për treg.

Silosët përdoren për ruajtjen e ushqimit të shpezëve dhe sigurojnë furnizim të vazhdueshëm të fermave me ushqim gjatë ciklit të rritjes.

Të gjitha objektet dhe infrastruktura janë ekzistuese dhe në funksion, ndërsa ky Raport i VNM-së fokusohet në vlerësimin e ndikimeve mjedisore që krijohen gjatë funksionimit të fermave, silosëve, thertores dhe njësive përcjellëse.

3.12. Zona të ndjeshme, kërkime shkencore dhe zona me qëllime të veçanta

Lokacioni i projektit nuk ndodhet në zona të mbrojtura natyrore, parqe kombëtare, rezervate ekologjike ose zona me rëndësi të veçantë shkencore.

Bazuar në vlerësimin e lokacionit, zona karakterizohet nga ekosistem i zakonshëm rural dhe bujqesor, pa elemente të veçanta që mund të ndikohen ndjeshëm nga aktiviteti i lartecekur.

4. GJENDJA EKZISTUESE E MJEDISIT

Gjendja Gjendja ekzistuese e mjedisit në lokacionin e kompanisë "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. dhe në zonën përreth paraqet bazën për vlerësimin e ndikimeve që mund të shkaktohen nga funksionimi i fermave për rritjen e shpezëve, silosëve, thertores dhe njësive të përpunimit.

Lokacioni ndodhet në një zonë me karakter kryesisht bujqësor dhe rural, ku sipërfaqet përreth shfrytëzohen kryesisht për kultivimin e kulturave bujqësore sezonale, si gruri, misri dhe kultura të tjera. Në territorin e kompleksit janë të ndërtuara dhe funksionale objektet e aktivitetit, ndërsa gjendja e mjedisit ndikohet edhe nga përdorimi ekzistues i tokës dhe aktivitetet antropogjene në zonën përreth.

4.1. Degradimi i mjedisit

Në zonën ku ndodhet lokacioni nuk janë evidentuar forma të theksuara të degradimit të mjedisit që do të lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e aktivitetit. Territori përreth karakterizohet kryesisht nga përdorimi bujqësor, ndërsa në lokacion ekzistojnë objektet dhe infrastruktura e ndërtuar e kompanisë.

Ndikimet potenciale në mjedis gjatë funksionimit të aktivitetit mund të lidhen kryesisht me gjenerimin e mbetjeve dhe nënprodukteve me origjinë shtazore, ujërat e ndotura, aromat, emetimet në ajër, zhurmën dhe qarkullimin e automjeteve.

Zbatimi i masave të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve, ujërave të ndotura, ventilimit, pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve është i rëndësishëm për parandalimin e degradimit të mëtejshëm të mjedisit.

4.2. Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit në zonën e lokacionit ndikohet kryesisht nga karakteri rural dhe bujqësor i zonës, si dhe nga aktivitetet antropogjene dhe komunikacioni rrugor.

Gjatë funksionimit të fermave dhe thertores, burimet potenciale të ndikimit në ajër lidhen kryesisht me aromat nga rritja e shpezëve, menaxhimi i plehut dhe nënprodukteve shtazore, proceset e pastrimit, ventilimi i objekteve dhe lëvizja e automjeteve.

Në zonën përreth nuk janë evidentuar burime të mëdha industriale të ndotjes së ajrit. Për shkak të karakterit të aktivitetit, kontrolli i ventilimit, pastrimi i rregullt dhe menaxhimi i duhur i mbetjeve dhe nënprodukteve janë masa të rëndësishme për ruajtjen e cilësisë së ajrit.

4.3. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Në afërsi të lokacionit të kompanisë "HAPPY CHICKEN" SH.P.K., në një distancë prej rreth 100 m, kalon Lumi Toplluga, i cili është një nga rrjedhat ujore kryesore në territorin e Komunës së Prizrenit. Lumi Toplluga ka gjatësi rreth 37 km dhe derdhet në lumin Drini i Bardhë në zonën e Krajkut.

Prania e këtij lumi në afërsi të lokacionit paraqet një receptor të ndjeshëm mjedisor, veçanërisht në raport me menaxhimin e ujërave të ndotura, mbetjeve dhe nënprodukteve me origjinë shtazore. Për këtë arsye, gjatë funksionimit të aktivitetit duhet të sigurohet që ujërat e ndotura nga fermat, thertorja dhe hapësirat përcjellëse të mos shkarkohen drejtpërdrejt ose tërthorazi në lumin Toplluqa.

Furnizimi me ujë i kompanisë realizohet përmes puseve vetjake, të cilat përdoren për nevojat e fermave, thertores dhe proceseve përcjellëse. Për shkak të përdorimit të ujërave nëntokësore, është e rëndësishme që puset të mbrohen nga burimet potenciale të ndotjes dhe që cilësia e ujit të monitorohet në mënyrë periodike.

Ujërat e ndotura të krijuara nga pastrimi i fermave, thertores dhe pajisjeve teknologjike, si dhe ujërat sanitare, duhet të mblidhen dhe të menaxhohen përmes sistemit përkatës të kanalizimit dhe trajtimit, në mënyrë që të parandalohet ndotja e tokës, ujërave nëntokësore dhe e Lumit Toplluqa.

4.4. Toka dhe përdorimi i saj

Parcelat ku zhvillohet aktiviteti figurojnë në të dhënat kadastrale si tokë bujqësore, me mënyrë shfrytëzimi "arë", të klasës 5 dhe 6.

Në gjendjen faktike, një pjesë e konsiderueshme e sipërfaqes së lokacionit është e zënë nga gjashtë fermat, thertorja, silosët dhe objektet e tjera përcjellëse, ndërsa pjesët e tjera shfrytëzohen për rrugë të brendshme, parking, ngarkim-shkarkim, sipërfaqe të gjelbra dhe hapësira të tjera funksionale.

Toka në zonën përreth përdoret kryesisht për prodhim bujqësor, ku kultivohen kultura sezonale, veçanërisht gruri dhe misri.

Ndikimi potencial i aktivitetit në tokë lidhet kryesisht me menaxhimin e mbetjeve, plehut të shpezëve, nënprodukteve të therjes, ujërave të ndotura dhe substancave të përdorura për pastrim

dhe dezinfektim. Për këtë arsye, menaxhimi i kontrolluar i këtyre materialeve është i domosdoshëm për mbrojtjen e tokës nga ndotja.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

Meqenëse aktiviteti i kompanisë "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. është ekzistues, objektet janë të ndërtuara dhe proceset teknologjike janë në funksion, shqyrtimi i alternativave të projektit është bërë duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese të lokacionit, funksionimin e objekteve, kushtet teknike dhe nevojën për mbrojtjen e mjedisit.

Në këtë kuadër janë shqyrtuar alternativat që lidhen me vazhdimin e aktivitetit në lokacionin ekzistues, përmirësimin e mënyrës së funksionimit dhe menaxhimin e ndikimeve mjedisore, si dhe alternativa "pa veprim".

5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Për aktivitetin ekzistues janë shqyrtuar këto alternativa:

- Alternativa 1 – Vazhdimi i aktivitetit në lokacionin ekzistues, duke përdorur objektet dhe infrastrukturën ekzistuese;
- Alternativa 2 – Përmirësimi i proceseve teknologjike dhe masave mjedisore, përmes përdorimit më efikas të ujit dhe energjisë, përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve dhe ujërave të ndotura dhe kontrollit të aromave e zhurmës;
- Alternativa 3 – Alternativa pa veprim, që nënkupton ndërprerjen e aktivitetit dhe mosfunksionimin e objekteve ekzistuese.

Duke marrë parasysh se objekti është ekzistues, ndërtimi i një lokacioni të ri nuk konsiderohet alternativë e arsyeshme në kushtet aktuale.

5.2. Arsyet kryesore për zgjedhjen e alternativës së caktuar

Alternativa e preferuar është vazhdimi i aktivitetit në lokacionin ekzistues, i shoqëruar me zbatimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit.

Kjo alternativë është e arsyeshme për shkak se:

- objektet e fermave, thertores dhe infrastrukturës përcjellëse janë tashmë të ndërtuara;
- lokacioni ka qasje të përshtatshme në rrjetin rrugor;
- aktiviteti zhvillohet në një zonë me karakter bujqësor dhe ekonomik;

- ekziston infrastruktura e nevojshme teknike;
- zhvendosja e aktivitetit do të kërkonte investime të reja dhe shfrytëzim të një sipërfaqeje tjetër;
- ndikimet mjedisore mund të kontrollohen përmes masave teknike dhe organizative.

5.3. Vendndodhja ose rruga

Lokacioni ekzistues përfshin parcelat P-71813037-00183-0, P-71813037-00184-0 dhe P-71813084-00190-0, në Zonat Kadastrale Korishë dhe Shpenadi.

Lokacioni ka qasje përmes rrugës ekzistuese që lidhet me rrugën magjistrale Prizren–Suharekë, duke mundësuar furnizimin e kompleksit dhe transportin e produkteve të gatshme.

Duke qenë se aktiviteti është ekzistues, nuk parashihet hapja e rrugëve të reja apo ndërtimi i një infrastrukture të re rrugore për realizimin e projektit.

5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Ndikimet potenciale të aktivitetit lidhen kryesisht me:

- emetimet dhe aromat në ajër;
- ujërat e ndotura;
- mbetjet dhe nënproduktet me origjinë shtazore;
- zhurmën;
- konsumin e ujit dhe energjisë;
- qarkullimin e automjeteve.

Për shkak se Lumi Toplluga ndodhet rreth 100 m nga lokacioni, menaxhimi i ujërave të ndotura dhe parandalimi i çdo shkarkimi të pakontrolluar paraqesin masë me rëndësi të veçantë.

Zbatimi i masave të përcaktuara në këtë Raport të VNM-së synon minimizimin e ndikimeve në mjedis dhe mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe komunitetit përreth.

Ndikimi në cilësinë e ajrit

Ndikimet në ajër mund të shkaktohen kryesisht nga aromat e krijuara gjatë rritjes së shpezëve, menaxhimit të plehut dhe nënprodukteve shtazore, si dhe nga qarkullimi i automjeteve.

Kontrolli i ventilimit, pastrimi dhe dezinfektimi i rregullt i objekteve, menaxhimi i duhur i mbetjeve dhe mirëmbajtja e pajisjeve do të kontribuojnë në reduktimin e këtyre ndikimeve.

5.5. Proceset dhe teknologjia e prodhimit

Procesi teknologjik përfshin çeljen e zogjve, rritjen e pulave, furnizimin me ushqim dhe ujë, transportimin e tyre në thertore, therjen, përpunimin dhe përgatitjen e produkteve të mishit të shpezëve për treg.

Ushqimi ruhet në silosët ekzistues, ndërsa proceset realizohen në objektet përkatëse të fermave dhe thertores.

Teknologjia ekzistuese duhet të mirëmbahen dhe të operohet në mënyrë që të sigurohet efikasiteti i procesit dhe minimizimi i ndikimeve mjedisore.

5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit

Meqenëse objektet janë ekzistuese, nuk parashihet fazë e re ndërtimore. Gjatë funksionimit, puna organizohet sipas proceseve teknologjike të fermave dhe thertores.

Metodat e punës duhet të bazohen në:

- zbatimin e kërkesave higjieno-sanitare;
- mirëmbajtjen e pajisjeve;
- përdorimin racional të ujit dhe energjisë;
- menaxhimin e kontrolluar të mbetjeve;
- mirëmbajtjen e sistemeve të ventilimit dhe kanalizimit;
- zbatimin e masave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

5.7. Plani i lokacionit

Plani i lokacionit paraqet gjendjen ekzistuese të kompleksit dhe përfshin gjashtë fermat për çeljen dhe rritjen e pulave, thertoren, silosët, objektet përcjellëse, rrugët e brendshme, hapësirat e parkingut, zonat e gjelbra dhe infrastrukturën teknike.

Planimetria e lokacionit do të paraqitet në pjesën grafike të Raportit të VNM-së.

5.8. Lloji dhe përzgjedhja e materialeve për realizimin e projektit

Për shkak se objektet janë ekzistuese, nuk parashihet përdorimi i sasive të konsiderueshme të materialeve ndërtimore të reja.

Gjatë funksionimit përdoren kryesisht ushqimi për shpezë, materiale për pastrim dhe dezinfektim, ambalazhe, materiale ndihmëse dhe materiale të tjera të nevojshme për procesin teknologjik.

5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Meqenëse aktiviteti dhe objektet janë ekzistuese, nuk parashihet afat i ri për përfundimin e punimeve ndërtimore.

Aktiviteti do të vazhdojë të funksionojë në përputhje me lejet, pëlqimet dhe kërkesat ligjore mjedisore të aplikueshme.

5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Lokacioni përfshin tri parcela kadastrale me sipërfaqe totale prej 27,668.9 m², ose rreth 2.77 ha.

Në këtë sipërfaqe janë të vendosura gjashtë fermat, thertorja, silosët dhe objektet e tjera përcjellëse.

5.11. Vëllimi i prodhimit

Vëllimi i prodhimit lidhet me kapacitetin e gjashtë fermave për rritjen e shpezëve përafërisht secila nga 20.000 copë dhe kapacitetin e thertores dhe njësisë së përpunimit.

5.12. Kontrolli i ndotjes

Kontrolli i ndotjes realizohet përmes masave për:

- menaxhimin e ujërave të ndotura;
- menaxhimin e mbetjeve dhe nënprodukteve shtazore;
- kontrollin e aromave dhe emetimeve në ajër;
- kontrollin e zhurmës;
- mirëmbajtjen e sistemeve të ventilimit dhe kanalizimit;
- mbrojtjen e tokës dhe ujërave nëntokësore;
- mbrojtjen e Lumit Toplluqa nga ndotja.

5.13. Trajtimi i mbeturinave

Mbetjet e krijuara gjatë aktivitetit ndahen sipas llojit dhe menaxhohen në mënyrë të kontrolluar.

Vëmendje e veçantë i kushtohet plehut të shpezëve, nënprodukteve të therjes dhe mbetjeve të tjera organike, të cilat duhet të grumbullohen, ruhen dhe largohen në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

Mbetjet komunale, ambalazhet dhe mbetjet e tjera menaxhohen veçmas dhe dorëzohen te operatorët e autorizuar, sipas llojit të mbetjes.

5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes

Lokacioni ka qasje përmes rrjetit ekzistues rrugor. Nuk parashihet ndërtimi i rrugëve të reja për realizimin e aktivitetit.

Mirëmbajtja e rrugëve dhe hapësirave të brendshme siguron qarkullim të sigurt të automjeteve për furnizim dhe transport të produkteve.

5.15. Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit

Për menaxhimin e mjedisit është përgjegjës operatori i aktivitetit, i cili duhet të sigurojë zbatimin e masave të përcaktuara në Raportin e VNM-së dhe në dokumentet/lejet përkatëse mjedisore.

Operatori duhet të përcaktojë personat përgjegjës për kontrollin e mbetjeve, ujërave të ndotura, pajisjeve teknike dhe zbatimin e masave mjedisore.

5.16. Trajnimet

Punëtorët duhet të trajnohen për higjienën dhe sigurinë në punë, menaxhimin e mbetjeve, përdorimin e substancave për pastrim dhe dezinfektim, parandalimin e ndotjes dhe veprimet në raste emergjente.

Trajnimet duhet të përsëriten periodikisht dhe sa herë që ndryshojnë proceset ose pajisjet e punës.

5.17. Monitorimi

Monitorimi duhet të përfshijë kontrollin e:

- konsumit të ujit dhe energjisë;
- cilësisë dhe menaxhimit të ujërave të ndotura;
- mbetjeve dhe nënprodukteve shtazore;
- aromave dhe emetimeve në ajër;
- zhurmës, sipas nevojës;
- gjendjes së tokës dhe ujërave nëntokësore;
- gjendjes së Lumit Toplluga, veçanërisht në rast të ndonjë shkarkimi ose incidenti.

5.18. Planet për situata emergjente

Operatori duhet të ketë procedura për reagim në raste emergjente, përfshirë zjarret, rrjedhjet e ujërave të ndotura, derdhjen e substancave kimike, dëmtimin e sistemit të kanalizimit, ndërprerjen e energjisë elektrike dhe incidentet e tjera që mund të shkaktojnë ndikime në mjedis.

Në rast incidenti me potencial për ndotjen e Lumit Toplluga, duhet të ndërmerren menjëherë masat për ndalimin e burimit të ndotjes dhe kufizimin e përhapjes së saj.

5.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Në rast të ndërprerjes përfundimtare të aktivitetit, operatori duhet të përgatisë planin për çmontimin ose demolimin e objekteve, largimin e pajisjeve, menaxhimin e mbetjeve dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të lokacionit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Plani për menaxhimin e mjedisit do të përcaktojë masat konkrete për parandalimin dhe minimizimin e ndikimeve në ajër, ujë, tokë, florë dhe faunë, si dhe përgjegjësitë, mënyrën dhe periodicitetin e monitorimit.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet menaxhimit të ujërave të ndotura dhe mbetjeve, për shkak të afërsisë së Lumit Toplluqa dhe përdorimit të ujërave nëntokësore përmes puseve vetjake.

5.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim

Alternativa "pa veprim" nënkupton ndërprerjen e aktivitetit ekzistues dhe mosshfrytëzimin e objekteve të fermave, thertores dhe infrastrukturës përcjellëse.

Kjo alternativë do të eliminonte ndikimet mjedisore që krijohen nga funksionimi i aktivitetit, por njëkohësisht do të shkaktonte ndërprerjen e aktivitetit ekonomik, humbjen e vendeve të punës dhe mosshfrytëzimin e investimeve dhe infrastrukturës ekzistuese.

Për këtë arsye, alternativa më e përshtatshme konsiderohet vazhdimi i aktivitetit në lokacionin ekzistues, duke zbatuar masat e nevojshme për parandalimin, zvogëlimin dhe kontrollin e ndikimeve në mjedis.

6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

6.1. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis

Aktiviteti i "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. përfshin funksionimin e gjashtë fermave për çeljen dhe rritjen e pulave, silosëve për ruajtjen e ushqimit, thertores dhe hapësirave për përpunimin e produkteve të mishit të shpezëve, si dhe aktivitetet përcjellëse të transportit, pastrimit, dezinfektimit dhe menaxhimit të mbetjeve.

Ndikimet potenciale në mjedis lidhen kryesisht me emetimet në ajër, përdorimin e ujit, gjenerimin e ujërave të ndotura, mbetjet nga fermat dhe thertorja, zhurmën, trafikun dhe rrezikun nga situatat aksidentale.

Nga procesi i therjes krijohen nënprodukte dhe mbetje me origjinë shtazore, ndër të cilat gjaku, puplat, pjesët dhe indet e papërshtatshme për konsum, përmbajtja e traktit gastrointestinal, yndyrnat dhe mbetjet e tjera organike. Menaxhimi jo i duhur i tyre mund të shkaktojë erëra të pakëndshme, ndotje të tokës dhe ujërave dhe rrezik sanitar.

Në afërsi të lokacionit, në distancë rreth 100 m, ndodhet rrjedha e lumit Toplluqa, ndërsa furnizimi me ujë i aktivitetit bëhet përmes puseve vetjake. Për këtë arsye, mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore paraqet një aspekt të rëndësishëm të menaxhimit mjedisor.

Në përgjithësi, ndikimet vlerësohen si lokale dhe të menaxhueshme, me kusht që të zbatohen masat e përcaktuara në këtë Raport të VNM-së.

6.2. Cilësia e ajrit

Ndikimet potenciale në cilësinë e ajrit gjatë funksionimit të aktivitetit lidhen kryesisht me aromat, pluhurat dhe emetimet që krijohen nga fermat, thertorja, silosët dhe lëvizja e automjeteve.

Burimet kryesore janë:

- ventilimi i fermave;
- menaxhimi i plehut të shpezëve;
- ruajtja dhe manipulimi i ushqimit në silosë;
- procesi i therjes dhe përpunimit;
- gjaku dhe mbetjet organike;
- puplat dhe materialet e tjera të mbetura nga therja;
- ujërat e ndotura me ngarkesë organike;
- qarkullimi i automjeteve.

Mungesa e menaxhimit të rregullt të mbetjeve organike mund të shkaktojë krijimin e aromave të pakëndshme, veçanërisht gjatë periudhave me temperatura të larta.

Për minimizimin e ndikimeve kërkohet pastrimi dhe dezinfektimi i rregullt, ventilimi adekuat, menaxhimi i shpejtë i mbetjeve dhe mirëmbajtja e pajisjeve.

6.3. Ndikimi i projektit në klimë

Aktiviteti mund të kontribuojë në emetimet e gazeve me efekt serrë përmes konsumit të energjisë elektrike, përdorimit të karburanteve nga automjetet dhe proceseve biologjike që zhvillohen në fermat e shpezëve dhe gjatë menaxhimit të plehut dhe mbetjeve organike.

Ndikimi i aktivitetit në klimën globale pritet të jetë i kufizuar. Reduktimi i konsumit të energjisë, mirëmbajtja e pajisjeve, përdorimi racional i ujit dhe organizimi efikas i transportit mund të kontribuojnë në uljen e emetimeve.

6.5. Mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit

Emetimet e krijuara nga aktiviteti janë kryesisht me karakter lokal dhe lidhen me burimet brenda kompleksit.

Duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e aktivitetit, nuk pritet ndikim i rëndësishëm ndërkufitar në cilësinë e ajrit.

6.6. Cilësia e ujit

Uji për nevojat e aktivitetit sigurohet përmes puseve vetjake të hapura nga kompania.

Uji përdoret për nevojat e fermave, thertores, pastrimit, higjienës, dezinfektimit dhe aktiviteteve të tjera përcjellëse.

Thertorja paraqet një nga burimet kryesore të konsumit të ujit dhe gjenerimit të ujërave të ndotura.

Gjatë procesit krijohen ujëra nga therja, larja dhe pastrimi i pajisjeve dhe sipërfaqeve.

Këto ujëra mund të përmbajnë gjak, yndyrna, proteina, grimca organike, detergjentë dhe dezinfektues, prandaj duhet të menaxhohen në mënyrë të kontrolluar.

6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Burimet potenciale të ndotjes së ujërave janë ujërat e ndotura nga fermat dhe thertorja, mbetjet organike, plehu i shpezëve, gjaku, yndyrnat dhe substancat e përdorura për pastrim dhe dezinfektim.

Rreziku është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të afërsisë së lumit Toplluga, rreth 100 m nga lokacioni, si dhe përdorimit të ujërave nëntokësore nga puset vetjake.

Çdo shkarkim i pakontrolluar në tokë, kanale ose në rrjedhën ujore duhet të parandalohet.

Sistemi i kanalizimit duhet të kontrollohet dhe mirëmbajtja të bëhet në mënyrë të rregullt për të parandaluar rrjedhjet dhe depërtimin e ndotësve në tokë dhe ujëra nëntokësore.

6.8. Mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave

Duke marrë parasysh karakterin dhe shkallën e aktivitetit, nuk pritet që funksionimi i fermave dhe thertores të shkaktojë ndotje ndërkufitare të ujërave.

Ndikimet e mundshme janë të kufizuara në nivel lokal dhe lidhen kryesisht me menaxhimin e ujërave të ndotura dhe mbetjeve.

6.9. Ndryshimet hidromorfologjike

Objektet e aktivitetit janë ekzistuese dhe nuk parashihet ndërhyrje e re në rrjedhën ose shtratin e lumit Toplluga.

Për këtë arsye, funksionimi i aktivitetit nuk pritet të shkaktojë ndryshime të rëndësishme hidromorfologjike.

6.10. Toka

Ndikimet potenciale në tokë lidhen kryesisht me menaxhimin e plehut të shpezëve, mbetjeve nga thertorja, ujërave të ndotura dhe substancave të përdorura gjatë pastrimit.

Nëse gjaku, puplat, indet, yndyrnat dhe mbetjet e tjera organike depozitohen në mënyrë të pakontrolluar, mund të shkaktojnë ndotje të tokës dhe krijimin e aromave të pakëndshme.

Për këtë arsye, mbetjet duhet të grumbullohen dhe ruhen në kushte të përshtatshme dhe të largohen në mënyrë të kontrolluar.

6.11. Ndikimi fizik dhe topografia

Objektet janë të ndërtuara dhe lokacioni është kryesisht i rrafshët.

Meqenëse nuk parashihen ndërtime të reja me ndërhyrje të rëndësishme në terren, nuk priten ndikime të reja të rëndësishme fizike apo ndryshime të topografisë.

6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në tokë

Ndotja e tokës mund të ndodhë në rast të rrjedhjeve të ujërave të ndotura ose depozitimit të pakontrolluar të mbetjeve organike dhe substancave kimike.

Veçanërisht duhet të parandalohet depërtimi në tokë i gjakut, yndyrave dhe mbetjeve organike të krijuara gjatë procesit të therjes.

Sipërfaqet e punës dhe hapësirat ku kryhen aktivitetet duhet të mirëmbahen dhe pastrohen rregullisht.

6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore

Lokacioni shfrytëzohet për aktivitetin ekzistues të fermave dhe thertores dhe nuk parashihet zënia e sipërfaqeve të reja.

Burimi natyror kryesor i përdorur është uji nëntokësor nga puset vetjake. Për këtë arsye duhet të sigurohet përdorimi racional i ujit dhe mirëmbajtja e puseve dhe sistemeve të furnizimit.

6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur

Nuk parashihet humbje e re e tokës bujqësore, pasi objektet janë ekzistuese.

Sipërfaqet e lokacionit janë të zëna nga objektet, rrugët e brendshme, hapësirat teknike dhe sipërfaqet përcjellëse. Hapësirat përreth lokacionit përdoren kryesisht për kultivimin e grurit, misrit dhe kulturave të tjera sezonale.

6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike

Funksionimi i aktivitetit nuk shkakton ndryshime të rëndësishme në strukturën gjeologjike ose në karakteristikat gjeomorfologjike të terrenit.

Ndikimi vlerësohet si minimal, pasi nuk parashihen punime të reja të rëndësishme tokësore.

6.16. Ndikimi në popullsinë lokale

Ndikimet potenciale në popullsinë lokale mund të lidhen me aromat, zhurmën, trafikun dhe menaxhimin e mbetjeve.

Objektet më të afërta të banimit ndodhen rreth 430 m, ndërsa zona më intensive e banimit në Shpenadi rreth 900 m nga lokacioni.

Nëse zbatohen masat higjieno-sanitare dhe mjedisore, ndikimet në komunitetin lokal pritet të jenë të kufizuara.

6.17. Ndikimi në shëndetin e popullsisë

Rreziku potencial për shëndetin e popullsisë lidhet kryesisht me menaxhimin jo të duhur të mbetjeve organike, ujërave të ndotura, aromave dhe ndotësve të mundshëm.

Menaxhimi i rregullt i mbetjeve të fermave dhe thertores, pastrimi dhe dezinfektimi i hapësirave, kontrolli i dëmtuesve dhe mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura janë masa të rëndësishme për parandalimin e rreziqeve sanitare.

Duke marrë parasysh distancën nga zonat e banuara dhe zbatimin e masave të përcaktuara, nuk pritet ndikim i rëndësishëm në shëndetin e komunitetit përreth.

6.18. Rreziku nga aksidentet dhe situatat emergjente

Rreziqet kryesore gjatë funksionimit janë:

- zjarri;
- defektet elektrike;
- rrjedhjet e ujërave të ndotura;
- derdhjet aksidentale të substancave kimike;
- prishjet e pajisjeve;
- aksidentet gjatë transportit;
- përhapja e pakontrolluar e mbetjeve organike.

Për menaxhimin e situatave emergjente duhet të sigurohen pajisje kundër zjarrit, mjete të ndihmës së parë dhe procedura për reagim të shpejtë ndaj incidenteve.

6.19. Ndikimi psikologjik dhe social

Aktiviteti ka ndikim pozitiv social përmes punësimit të punëtorëve, krijimit të të ardhurave dhe furnizimit të tregut me produkte ushqimore.

Ndikimet potenciale negative mund të lidhen me aromat, zhurmën, trafikun dhe shqetësimet e mundshme të komunitetit.

Këto ndikime mund të zvogëlohen përmes mirëmbajtjes së rregullt të objekteve, menaxhimit të mbetjeve dhe komunikimit të mirë me komunitetin lokal.

6.24. Ndikimi në ekosistemet lokale

Zona përreth lokacionit karakterizohet kryesisht nga agro-ekosisteme, ku kultivohen grurë, misër dhe kultura të tjera bujqësore sezonale.

Nuk janë evidentuar habitate të veçanta ekologjike brenda lokacionit.

Ndikimet në ekosistemet lokale mund të lidhen kryesisht me ndotjen e mundshme të tokës dhe ujërave. Me zbatimin e masave të menaxhimit mjedisor, ndikimi pritet të jetë i kufizuar.

6.25. Ruajtja e biodiversitetit

Në lokacion nuk janë evidentuar specie të rralla ose të rrezikuara dhe as habitate të veçanta që mund të ndikohen drejtpërdrejt nga aktiviteti.

Ruajtja e biodiversitetit do të sigurohet përmes parandalimit të ndotjes së ujërave dhe tokës, menaxhimit të mbetjeve dhe ruajtjes së sipërfaqeve të gjelbra.

6.26. Ndikimi në strukturën gjeologjike dhe gjeomorfologjike

Për shkak se aktiviteti zhvillohet në objekte ekzistuese dhe nuk parashihen ndërhyrje të reja të rëndësishme në terren, nuk priten ndikime të rëndësishme në strukturën gjeologjike dhe gjeomorfologjike.

6.27–6.29. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve

Sipërfaqja e lokacionit shfrytëzohet për funksionimin e fermave, thertores dhe njësive përcjellëse. Në kompleks janë të vendosura:

- gjashtë ferma për çeljen dhe rritjen e pulave;
- thertorja;
- hapësirat për përpunimin e mishit;
- silosët për ruajtjen e ushqimit;
- hapësirat teknike dhe ndihmëse;
- rrugët dhe hapësirat e qarkullimit;
- hapësirat për ngarkim-shkarkim;
- sipërfaqet e gjelbra.

Nuk parashihet zgjerim i rëndësishëm i sipërfaqes së shfrytëzuar.

6.30–6.33. Infrastruktura komunale

Lokacioni disponon infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit, përfshirë furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ujë përmes puseve vetjake, sistemin e kanalizimit, rrugët e brendshme dhe qasjen në rrjetin rrugor.

Qasja në kompleks realizohet përmes rrugës sekondare që lidhet me rrugën magjistrale Prizren–Suharekë.

6.34–6.35. Ujërat e zeza dhe gjenerimi i mbeturinave

Gjatë funksionimit të fermave dhe thertores gjenerohen ujëra të ndotura nga pastrimi, larja dhe dezinfektimi i objekteve, pajisjeve dhe hapësirave teknologjike.

Në veçanti, ujërat e ndotura nga thertorja mund të përmbajnë gjak, yndyrna, proteina, materiale organike, grimca të indeve, detergjentë dhe dezinfektues, duke pasur ngarkesë të konsiderueshme organike.

Mbetjet dhe nënproduktet kryesore të aktivitetit janë:

- plehu i shpezëve;
- shpezët e ngordhura;
- gjaku;
- puplat;
- pjesët dhe indet e papërshtatshme për konsum;
- përmbajtja e traktit gastrointestinal;
- yndyrnat;
- mbetjet e tjera organike nga procesi i therjes;
- mbetjet komunale;
- ambalazhet dhe mbetjet e tjera të procesit.

Këto mbetje duhet të ndahen sipas llojit, të grumbullohen në mënyrë të kontrolluar, të ruhen përkohësisht në kushte të përshtatshme dhe të largohen ose trajtohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe përmes operatorëve të autorizuar, sipas kategorisë së mbetjes.

Për shkak të afërsisë së lumit Toplluqa dhe përdorimit të puseve vetjake, është veçanërisht e rëndësishme që asnjë mbetje apo ujë i ndotur të mos shkarkohet drejtpërdrejt në tokë, kanale apo në rrjedhën ujore.

Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit
	Letra	Jo të rezikshme	Kontejner
13 01 13 02	Vajra dhe lubrikante te perdorura	Te rrezikshme	Bure
15 01 01 20 01 01 20 01 08	Mbeturinat e ngurta komunale	Jo te rrezikshme	Kontejner për mbeturina
02 02 07 02 02 02 02 02 03 02 02 04 02 02 99	Llumrat që vijnë nga larja dhe pastrimi Mbeturinat nga indet e shtazëve Materiale jo të përshtatshme për konsumim dhe konzervim Llumrat që rrjedhin nga vend trajtimi Mbeturinat të pa specifikuara ndryshe	Të rrezikëshme	Tek kompanitë e licencuara për grumbullimin e tyre

6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore dhe kulturore

Në lokacionin e aktivitetit dhe në hapësirat e afërta, bazuar në të dhënat e disponueshme dhe vëzhgimin në terren, nuk janë evidentuar pasuri të mbrojtura natyrore ose objekte të veçanta të trashëgimisë kulturore që mund të ndikohen drejtpërdrejt nga aktiviteti.

Në rast të evidentimit të ndonjë gjurme apo objekti me vlerë potenciale arkeologjike ose kulturore gjatë ndërhyrjeve të ardhshme, punimet duhet të ndërpriten dhe të njoftohen institucionet kompetente.

7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

7.1. Masat e parashikuara me legjislacion

Operatori "HAPPY CHICKEN" SH.P.K., gjatë funksionimit të fermave, thertores dhe njësive përcjellëse, është i obliguar të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe të ndërmarrë masa për parandalimin, zvogëlimin dhe kontrollin e ndikimeve negative në ajër, ujë, tokë, shëndetin e njeriut dhe biodiversitet. VNM-ja synon pikërisht identifikimin dhe vlerësimin e këtyre ndikimeve dhe përcaktimin e masave për menaxhimin e tyre.

Masat e mëposhtme zbatohen gjatë funksionimit të aktivitetit dhe duhet të integrohen në mënyrën e përditshme të menaxhimit të kompleksit.

7.1.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në ajër dhe veçanërisht të aromave të pakëndshme, operatori duhet të zbatojë këto masa:

- Të sigurohet ventilimi i rregullt dhe funksional i objekteve të fermave dhe thertores.
- Të mirëmbahen rregullisht sistemet e ventilimit dhe pajisjet teknologjike.
- Të parandalohet grumbullimi i zgjatur i plehut të shpezëve.
- Të bëhet largimi i rregullt i mbetjeve organike nga thertorja.
- Gjaku, puplat, yndyrnat, indet dhe pjesët e tjera organike të mos lihen të ekspozuara ndaj temperaturave të larta dhe ambientit të jashtëm.
- Mbetjet nga procesi i therjes të grumbullohen në enë të përshtatshme dhe të mbyllura, sipas natyrës së tyre.
- Të pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht hapësirat e thertores dhe fermave.
- Të kontrollohen dhe mirëmbahen silosët dhe sistemet e transportimit të ushqimit për të parandaluar shpërndarjen e pluhurit.
- Të kufizohet krijimi i pluhurit gjatë lëvizjes së automjeteve në pjesët e pashtruara të kompleksit.
- Automjetet që transportojnë materiale me mundësi përhapjeje të pluhurit ose aromave të përdorin masa të përshtatshme mbrojtëse.
- Në rast të konstatimit të aromave të theksuara, të identifikohet burimi dhe të ndërmerren masa të menjëhershme korrigjuese.

7.1.2. Masat për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Duke pasur parasysh se Lumi Toplluga ndodhet rreth 100 m nga lokacioni dhe se furnizimi me ujë bëhet përmes puseve vetjake, mbrojtja e ujërave duhet të jetë një nga prioritetet kryesore të menaxhimit mjedisor.

Për këtë qëllim:

- Ndalohet çdo shkarkim i drejtpërdrejtë i ujërave të ndotura në lum.
- Ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura drejtpërdrejt në tokë.
- Të gjitha ujërat e ndotura nga thertorja dhe fermat duhet të mblidhen përmes sistemit përkatës të kanalizimit dhe te trajtohen në impiantin për trajtimin e ujit të ndotur.

- Të ndërtohet Impianti per trajtimin e ujit të dal nga procesi teknologjik.
- Të montohen seperatort e ndarjes se vajërave dhe gjakut nga uji.
- Të kontrollohet rregullisht sistemi i kanalizimit për rrjedhje, bllokime ose dëmtime.
- Të parandalohet depërtimi i gjakut, yndyrave dhe materialeve organike në tokë.
- Zonat e thertores ku zhvillohet therja dhe përpunimi duhet të jenë të përshtatshme për pastrim dhe larje.
- Detergjentët dhe dezinfektuesit duhet të përdoren në sasi të kontrolluara.
- Të parandalohet derdhja aksidentale e karburanteve, vajrave dhe substancave kimike.
- Puset vetjake duhet të mirëmbahen dhe të mbrohen nga burimet potenciale të ndotjes.
- Të kryhet, sipas kërkesave të lejes dhe programit të monitorimit, kontrolli i cilësisë së ujit dhe ujërave të ndotura.

Pra, duke pasur parasysh se Lumi ndodhet shumë afër nga lokacioni dhe furnizimi me ujë bëhet përmes puseve vetjake, të gjitha ujërat e ndotura nga fermat dhe thertorja duhet të mblidhen përmes rrjetit të kanalizimit dhe të trajtohen në një impiant për trajtimin e ujërave të ndotura, i cili duhet të përfshijë fazat e para-trajtimit, ndarjen e yndyrave dhe materialeve të ngurta, sedimentimin dhe trajtimin biologjik. Gjaku, puplat dhe mbetjet e tjera organike nga procesi i therjes duhet të grumbullohen veçmas dhe të mos shkarkohen në kanalizim. Ndalohet çdo shkarkim i ujërave të patrajtuara në lumë ose në tokë, ndërsa rrjeti i kanalizimit, impianti dhe puset vetjake duhet të kontrollohen dhe mirëmbahen rregullisht për të parandaluar rrjedhjet dhe ndotjen e ujërave nëntokësore. Cilësia e ujërave të ndotura dhe e ujit të trajtuar duhet të monitorohet periodikisht sipas kërkesave të lejes mjedisore dhe legjislacionit në fuqi.

7.1.3. Masat për menaxhimin e mbetjeve dhe nënprodukteve të thertores

Menaxhimi i mbetjeve paraqet një nga masat më të rëndësishme për këtë aktivitet.

Nga procesi i therjes krijohen gjak, pupla, pjesë dhe inde të papërshtatshme për konsum, përmbajtje e traktit gastrointestinal, yndyrna dhe mbetje të tjera organike.

Për menaxhimin e tyre duhet:

- Mbetjet të ndahen sipas llojit dhe karakteristikave.
- Të grumbullohen menjëherë pas krijimit.
- Të ruhen përkohësisht në hapësira të përshtatshme dhe të mbrojtura.

- Enët për mbledhjen e mbetjeve organike të jenë të përshtatshme, të pastrueshme dhe, kur është e nevojshme, të mbyllura.
- Të parandalohet rrjedhja e gjakut dhe lëngjeve organike në tokë ose kanalizim.
- Të parandalohet ekspozimi i mbetjeve organike ndaj temperaturave të larta dhe qëndrimi i tyre për periudha të gjata.
- Të sigurohet largimi i rregullt i tyre për trajtim, përpunim ose destinim të përshtatshëm, sipas kërkesave ligjore dhe përmes subjekteve të autorizuara kur kjo kërkohet.
- Hapësirat ku grumbullohen mbetjet të pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht.
- Të merren masa për parandalimin e pranisë së mizave, brejtësve dhe kafshëve të tjera.

Nuk duhet të lejohet në asnjë rast depozitimi i gjakut, puplave ose mbetjeve të tjera organike në tokë, në afërsi të lumit apo në hapësira të paautorizuara.

7.1.4. Masat për menaxhimin e plehut të shpezëve

Plehu i krijuar në fermat e shpezëve duhet të menaxhohet në mënyrë të kontrolluar.

Masat kryesore janë:

- Të parandalohet përhapja e plehut në sipërfaqe të papërshtatshme.
- Të kufizohet koha e qëndrimit të tij në hapësira të hapura.
- Të sigurohet ruajtja në kushte që parandalojnë rrjedhjen e lëngjeve në tokë.
- Të parandalohet kontakti i plehut me ujërat sipërfaqësore.
- Të parandalohet depozitimi i tij në afërsi të puseve.
- Gjatë transportit të merren masa për të parandaluar derdhjen dhe shpërndarjen e materialit.
- Të mbahet evidencë për sasinë dhe destinimin e plehut, sipas kërkesave të zbatueshme.

7.1.5. Masat për mbrojtjen e tokës

Për mbrojtjen e tokës duhet:

- Të mos depozitohen mbetje organike drejtpërdrejt në tokë.
- Të mirëmbahen sipërfaqet e betonizuara dhe të shtruara.
- Të parandalohet rrjedhja e ujërave të ndotura jashtë sistemit të kanalizimit.
- Të ruhen në mënyrë të sigurt detergjentët, dezinfektuesit, vajrat dhe substancat e tjera.
- Në rast të derdhjeve aksidentale të ndërhyhet menjëherë dhe të largohet materiali i ndotur.
- Mbetjet e kontaminuara të mos përzihen me mbetjet e zakonshme komunale.

7.1.6. Masat për mbrojtjen e ujërave nga aktiviteti i thertores

Për shkak të ngarkesës së mundshme të lartë organike të ujërave nga thertorja, duhet të zbatohen masa të veçanta:

- Të minimizohet futja e mbetjeve të ngurta në sistemin e kanalizimit.
- Gjaku dhe materialet e tjera organike të mblidhen para larjes së sipërfaqeve.
- Të përdoren grila ose sisteme të përshtatshme për ndalimin e materialeve të ngurta, kur janë të instaluara.
- Të mos përdoret uji në mënyrë të panevojshme gjatë pastrimit.
- Të kontrollohen rregullisht pikat e shkarkimit.
- Të parandalohet çdo shkarkim i ujërave të papërpunuara në mjedis.
- Nëse ekziston sistem trajtimi i ujërave të ndotura, ai duhet të mirëmbajë kapacitetin dhe funksionalitetin e tij.

7.1.7. Masat për zvogëlimin e zhurmës

Burimet kryesore të zhurmës janë pajisjet teknologjike, ventilatorët, kompresorët dhe automjetet.

Për reduktimin e zhurmës:

- Pajisjet të mirëmbahen rregullisht.
- Pajisjet që krijojnë zhurmë të lartë të kontrollohen dhe, kur është e nevojshme, të izolohën.
- Të shmanget përdorimi i panevojshëm i sinjaleve akustike.
- Automjetet të mos mbahen me motor të ndezur pa nevojë.
- Aktivitetet e ngarkim-shkarkimit të organizohen në mënyrë që të minimizohet shqetësimi për zonat e banuara.

7.1.8. Masat për mbrojtjen e florës, faunës dhe biodiversitetit

Për shkak të karakterit kryesisht bujqësor të zonës, ndikimet në biodiversitet pritet të jenë të kufizuara.

Megjithatë:

- Të parandalohet ndotja e ujërave dhe tokës.
- Të mos depozitohen mbetje në hapësirat e gjelbra.
- Të mirëmbahen sipërfaqet e gjelbra të kompleksit.
- Të merren masa për kontrollin e insekteve dhe brejtësve pa shkaktuar ndotje të mjedisit.

- Të parandalohet tërheqja e kafshëve dhe shpendëve të egër përmes mbetjeve ushqimore ose organike.

7.1.9. Masat për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe popullsisë

Operatori duhet të sigurojë kushte të përshtatshme higjieno-sanitare dhe të sigurisë në punë.

Në veçanti:

- Punëtorët duhet të pajisen me pajisje personale mbrojtëse.
- Të respektohen procedurat higjieno-sanitare në fermë dhe thertore.
- Të sigurohen kushte të përshtatshme për larjen dhe dezinfektimin.
- Punëtorët të trajnohen për manipulimin e mbetjeve organike.
- Të zbatohen procedurat për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve.
- Të sigurohet kontrolli dhe mirëmbajtja e pajisjeve teknologjike.
- Të vendosen udhëzime të qarta për veprim në rast aksidenti ose incidenti.

7.1.10. Masat për menaxhimin e aromave

Për këtë aktivitet, kontrolli i aromave është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të fermave dhe thertores.

Masat përfshijnë:

- largimin e rregullt të plehut;
- largimin e shpejtë të mbetjeve nga therja;
- moslejimin e qëndrimit të gjakut dhe materialeve organike në hapësira të hapura;
- pastrimin dhe dezinfektimin e rregullt;
- mirëmbajtjen e ventilimit;
- ruajtjen e mbetjeve në kushte të përshtatshme;
- kontrollin e temperaturës dhe kohës së ruajtjes së mbetjeve;
- kontrollin e insekteve dhe brejtësve.

7.1.11. Masat për mbrojtjen nga zjarri dhe situatat emergjente

Në kompleks duhet të sigurohen:

- aparate funksionale për fikjen e zjarrit;
- shenja dhe dalje emergjente;
- qasje e lirë për automjetet e emergjencës;

- kontroll periodik i instalimeve elektrike;
- procedura për reagim në rast zjarri;
- trajnimi i punëtorëve për reagim në situata emergjente;
- masa për parandalimin e derdhjeve aksidentale të substancave ndotëse.

Në rast të një incidenti që mund të shkaktojë ndotje të ujërave ose tokës, duhet të ndërmerren menjëherë masa për ndalimin e burimit dhe kufizimin e përhapjes së ndotjes.

7.1.12. Masat për mbrojtjen e Lumit Toplluga

Duke qenë se rrjedha e lumit Toplluqa ndodhet rreth 100 m nga lokacioni, operatori duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë mbrojtjes së tij.

Duhet të sigurohet:

- ndalimi i çdo shkarkimi të drejtpërdrejtë në lumë;
- ndalimi i depozitimit të mbetjeve në afërsi të rrjedhës ujore;
- kontrolli i kanalizimit;
- parandalimi i rrjedhjeve të gjakut dhe mbetjeve organike;
- kontrolli i rrjedhjeve të ujërave të ndotura;
- mirëmbajtja e sipërfaqeve të kompleksit;
- reagimi i menjëhershëm në rast të derdhjeve aksidentale.

Kjo masë është veçanërisht e rëndësishme për shkak të ndjeshmërisë së ujërave sipërfaqësore ndaj ngarkesës organike nga aktivitetet e fermave dhe thertores.

7.1.13. Masat për përdorimin racional të ujit

Meqenëse furnizimi bëhet përmes puseve vetjake, operatori duhet:

- të përdorë ujin në mënyrë racionale;
- të eliminojë rrjedhjet nga tubacionet dhe pajisjet;
- të kontrollojë rregullisht sistemin e furnizimit;
- të përdorë metoda efikase gjatë pastrimit;
- të mbajë evidencë mbi konsumin e ujit;
- të kontrollojë gjendjen e puseve dhe pajisjeve përkatëse.

7.1.14. Masat për monitorimin e ndikimeve në mjedis

Operatori duhet të organizojë monitorimin e ndikimeve sipas kushteve të përcaktuara në lejet dhe aktet përkatëse mjedisore.

Monitorimi duhet të fokusohet në:

- cilësinë e ujit, sipas kërkesave përkatëse;
- ujërat e ndotura;
- menaxhimin e mbetjeve;
- aromat dhe emetimet potenciale;
- zhurmën, kur paraqitet nevoja;
- gjendjen e sistemit të kanalizimit;
- gjendjen e puseve;
- incidentet dhe rastet e derdhjeve aksidentale.

Të gjitha të dhënat relevante duhet të dokumentohen dhe të ruhen në mënyrë të rregullt.

7.1.15. Përgjegjësia për zbatimin e masave mjedisore

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë Raport të VNM-së i takon operatorit "HAPPY CHICKEN" SH.P.K.

Operatori duhet të caktojë personin përgjegjës për:

- zbatimin e masave mjedisore;
- kontrollin e mbetjeve;
- kontrollin e ujërave të ndotura;
- mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimit;
- mbajtjen e evidencave;
- koordinimin e monitorimit;
- raportimin e incidenteve;
- komunikimin me institucionet kompetente.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit ka për qëllim kontrollin e ndikimeve që mund të shkaktohen nga funksionimi i fermave për rritjen e shpezëve, thertores dhe njësive për prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve.

Monitorimi do të përfshijë kryesisht:

- cilësinë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura;
- cilësinë e ujit të puseve vetjake;
- menaxhimin e gjakut, puplave dhe mbetjeve të tjera organike nga thertorja;
- menaxhimin e plehut të shpezëve;
- aromat dhe emetimet në ajër;
- zhurmën;
- gjendjen e tokës dhe sipërfaqeve të kompleksit;
- ndikimet e mundshme në lumin Toplluqa;
- zbatimin e masave të përcaktuara në Raportin e VNM-së.

Monitorimi duhet të realizohet nga personat përgjegjës të operatorit dhe, për parametrat që kërkojnë matje laboratorike, nga laboratorë ose subjekte të autorizuara.

8.2. Gjendja mjedisore para fillimit të aktiviteteve të projektit

Meqenëse objektet janë të ndërtuara dhe aktiviteti i fermave dhe thertores është në funksionim, gjendja mjedisore e lokacionit vlerësohet në fazën ekzistuese të operimit.

Lokacioni ndodhet në zonë me karakter kryesisht bujqësor, ku përreth zhvillohen aktivitete bujqësore dhe kultivohen kultura sezonale, kryesisht grurë, misër dhe kultura të tjera.

Në afërsi të lokacionit, në distancë rreth 100 m, kalon rrjedha e lumit Toplluga. Furnizimi me ujë për nevojat e aktivitetit sigurohet përmes puseve vetjake të hapura nga operatori.

Gjendja ekzistuese e mjedisit duhet të shërbejë si bazë për krahasimin e rezultateve të monitorimit gjatë funksionimit të aktivitetit.

8.3. Parametrat për përcaktimin e efektit të dëmshëm

Parametrat që do të monitorohen përcaktohen në bazë të burimeve potenciale të ndikimit.

Komponenti	Parametrat kryesorë
Uji i puseve	pH, turbullira, përçueshmëria, nitrate, nitrite, amonium, klorure, ngarkesa mikrobiologjike dhe parametra të tjerë sipas kërkesave laboratorike
Ujërat e ndotura	pH, BOD_5, COD, TSS, yndyrna dhe vajra, azot, fosfor dhe parametra mikrobiologjikë, sipas karakteristikave të shkarkimit
Ujërat sipërfaqësore	parametrat fizikë, kimikë dhe mikrobiologjikë relevantë për vlerësimin e ndikimit
Ajri	pluhuri dhe, sipas nevojës, parametrat që lidhen me aromat dhe procesin teknologjik
Mbetjet	sasia, lloji, mënyra e ruajtjes dhe destinimi
Zhurma	niveli i presionit akustik në pikat përfaqësuese
Toka	gjendja vizuale, ndotja eventuale dhe, në rast incidenti, parametrat përkatës laboratorikë
Aromat	prania, intensiteti dhe burimi i aromave të pakëndshme

8.4. Vendndodhjet, mënyra dhe shpeshtësia e matjeve

Monitorimi duhet të realizohet në pika që përfaqësojnë burimet kryesore të ndikimit.

Uji i puseve

Mostrat e ujit duhet të merren nga puset që përdoren për furnizimin e kompanisë dhe të analizohen në laborator të autorizuar.

Frekuenca: së paku një herë në vit ose më shpesh, nëse kërkohet nga kushtet e lejes mjedisore apo rezultatet e monitorimit.

Ujërat e ndotura

Mostrat duhet të merren në pikën përfaqësuese të shkarkimit, para dhe/ose pas trajtimit, varësisht nga sistemi ekzistues i menaxhimit të ujërave të ndotura.

Frekuenca: sipas kushteve të lejes mjedisore dhe kërkesave ligjore; në mungesë të një përcaktimi tjetër, monitorimi periodik duhet të planifikohet në mënyrë që të përfaqësojë kushtet normale të funksionimit.

Lumi

Për shkak të distancës së vogël nga lokacioni, sipas nevojës mund të bëhet monitorimi i ujit sipërfaqësor në pika përfaqësuese në rrjedhën para dhe pas lokacionit, me qëllim të identifikimit të ndonjë ndryshimi të mundshëm që lidhet me aktivitetin.

Ajri dhe aromat

Kontrolli bëhet përmes inspektimit periodik të burimeve të emetimeve, gjendjes së ventilimit dhe pranisë së aromave.

Frekuenca: kontroll i vazhdueshëm operacional dhe matje të specializuara kur kërkohet nga autoriteti kompetent ose kur evidentohen tejkalime/shqetësime.

Zhurma

Matjet e zhurmës duhet të kryhen në pikat përfaqësuese të lokacionit dhe, sipas nevojës, në drejtim të zonave më të afërta të banimit.

Frekuenca: periodike dhe sa herë që ndryshon pajisja teknologjike ose paraqitet ankesë e arsyeshme për zhurmë.

Mbetjet

Për mbetjet duhet të mbahet evidencë për:

- sasinë;
- llojin;
- mënyrën e ruajtjes;
- datën e largimit;
- subjektin që i pranon;
- destinimin përfundimtar.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për gjakun, puplat, mbetjet organike të therjes dhe plehun e shpezëve.

8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve

Rezultatet e monitorimit duhet të dokumentohen dhe të ruhen nga operatori.

Raportet duhet të përmbajnë së paku:

- datën dhe vendin e matjes;
- parametrat e analizuar;
- rezultatet laboratorike;
- krahasimin me vlerat kufitare të aplikueshme;
- interpretimin e rezultateve;

- masat korrigjuese, nëse është konstatuar tejkalim;
- dokumentacionin laboratorik përkatës.

Raportimi dhe dorëzimi i rezultateve tek institucionet kompetente bëhet në përputhje me kushtet e Pëlqimit dhe Lejes Mjedisore dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Në rast të tejkalimit të vlerave të lejuara ose të një incidenti mjedisor, operatori duhet të ndërmarrë masa korrigjuese dhe të njoftojë institucionet kompetente, kur kjo kërkohet.

8.6. Detyrimi për të informuar publikun

Operatori duhet të veprojë në mënyrë transparente lidhur me ndikimet mjedisore të aktivitetit.

Në rast të ndonjë incidenti që mund të paraqesë rrezik për mjedisin ose shëndetin e njerëzve, duhet të ndërmerren masat e nevojshme dhe të bëhet informimi i institucioneve kompetente në përputhje me legjislacionin.

Çdo ankesë eventuale nga banorët lidhur me aromat, zhurmën, pluhurin ose ndikime të tjera duhet të regjistrohet, të shqyrtohet dhe, nëse është e arsyeshme, të ndërmerren masa për eliminimin e shkakut.

8.7. Programi ndërkufitar i monitorimit të ndikimit në mjedis

Bazuar në karakteristikat dhe përmasat e aktivitetit, si dhe në natyrën lokale të ndikimeve të pritshme, nuk parashihet ndikim i rëndësishëm ndërkufitar në mjedis nga funksionimi i fermave dhe thertores.

Ndikimet potenciale janë kryesisht lokale dhe lidhen me ajrin, aromat, ujërat e ndotura, tokën, mbetjet dhe zhurmën.

Për këtë arsye, nuk parashihet program i veçantë i monitorimit ndërkufitar, përveç nëse në të ardhmen institucionet kompetente konstatojnë ndonjë rrethanë që kërkon monitorim të tillë.

Tabela përmbledhëse e programit të monitorimit

Komponenti	Pika e monitorimit	Frekuenca	Përgjegjës
Uji i puseve	Puset vetjake	Së paku 1 herë/vit	Operatori/laborator i autorizuar
Ujërat e ndotura	Pika e shkarkimit	Sipas lejes mjedisore	Operatori/laborator i autorizuar
Lumi Toplluga	Para/pas lokacionit, sipas nevojës	Periodike/sipas nevojës	Operatori/laborator i autorizuar

Aromat	Brenda dhe përreth kompleksit	E vazhdueshme	Operatori
Ajri	Pikat/burimet relevante	Sipas nevojës dhe lejes	Ekspert/laborator i autorizuar
Zhurma	Kufiri i lokacionit dhe pika përfaqësuese	Periodike/sipas ankesave	Ekspert i autorizuar
Mbetjet	Hapësirat e grumbullimit	E vazhdueshme	Operatori
Plehu i shpezëve	Hapësira e ruajtjes/menaxhimit	E vazhdueshme	Operatori
Toka	Sipërfaqet e kompleksit	Inspektim periodik	Operatori

Shënim: *Frekuencat përfundimtare të analizave laboratorike duhet të harmonizohen me kushtet që do të përcaktohen në Lejen mjedisore dhe Lejet ujore.*

9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Plani Plani i Menaxhimit Mjedisor për aktivitetin e "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. përcakton masat organizative dhe teknike që duhet të zbatohen gjatë funksionimit të fermave për rritjen e shpezëve, thertores dhe prodhimit të produkteve të mishit të shpezëve. Qëllimi i planit është parandalimi dhe minimizimi i ndikimeve në ajër, ujë, tokë, biodiversitet dhe shëndetin e njerëzve, si dhe sigurimi i menaxhimit të kontrolluar të mbetjeve dhe nënprodukteve të procesit të therjes.

Meqenëse objektet janë të ndërtuara dhe aktiviteti është në funksionim, plani fokusohet kryesisht në fazën e operimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme.

Gjatë funksionimit të aktivitetit, operatori duhet të sigurojë zbatimin e masave të përcaktuara në këtë Raport të VNM-së dhe në dokumentet mjedisore përkatëse.

Masat kryesore përfshijnë:

- mirëmbajtjen e rregullt të objekteve, pajisjeve dhe sistemeve të ventilimit;
- përdorimin racional të ujit dhe energjisë;
- mirëmbajtjen dhe kontrollin e puseve vetjake;
- menaxhimin e kontrolluar të ujërave të ndotura;
- parandalimin e çdo shkarkimi të drejtpërdrejtë në lumin Toplluqa;
- grumbullimin dhe menaxhimin e rregullt të plehut të shpezëve;

- grumbullimin e veçantë të gjakut, puplave dhe mbetjeve të tjera organike nga thertorja;
- ruajtjen e mbetjeve në kushte të përshtatshme dhe largimin e tyre përmes subjekteve të autorizuara, kur kërkohet;
- pastrimin dhe dezinfektimin e rregullt të hapësirave të fermave dhe thertores;
- kontrollin e aromave, pluhurit dhe zhurmës;
- parandalimin e ndotjes së tokës nga mbetjet, vajrat, karburantet dhe substancat kimike;
- mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra dhe sipërfaqeve të kompleksit;
- trajnimin e punëtorëve për mbrojtjen e mjedisit dhe reagimin në situata emergjente;
- mbajtjen e evidencave për mbetjet, ujërat, monitorimin dhe incidentet mjedisore.

Në rast të ndonjë derdhjeje aksidentale, prishjeje të sistemit të kanalizimit, zjarri apo incidenti tjetër që mund të shkaktojë ndotje, operatori duhet të ndërhyjë menjëherë për eliminimin e burimit të ndotjes dhe kufizimin e pasojave.

9.2. Pajtueshmëria me Pëlqimin Mjedisor

Kompania "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. është e obliguar të zhvillojë aktivitetin në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në Pëlqimin Mjedisor, si dhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Operatori duhet:

- të zbatojë të gjitha kushtet dhe masat e përcaktuara në Pëlqimin Mjedisor;
- të zbatojë programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis;
- të kryejë analizat dhe matjet e përcaktuara nga kushtet e lejes;
- të mbajë evidencë për mbetjet dhe mënyrën e menaxhimit të tyre;
- të sigurojë menaxhimin e përshtatshëm të mbetjeve të thertores dhe plehut të shpezëve;
- të mirëmbajë sistemet e ujësjellësit, kanalizimit dhe pajisjet e mbrojtjes së mjedisit;
- të raportojë rezultatet e monitorimit tek institucionet kompetente, sipas kërkesave të lejes;
- të njoftojë institucionet kompetente për incidentet mjedisore, kur kjo kërkohet;
- të sigurojë që çdo ndryshim i rëndësishëm në kapacitet, teknologji ose mënyrën e funksionimit të vlerësohet sipas kërkesave ligjore.

Pajtueshmëria me Pëlqimin Mjedisor duhet të kontrollohet në mënyrë periodike nga personi përgjegjës për çështjet mjedisore brenda kompanisë.

9.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me ISO 14000

Operatori inkurajohet që në të ardhmen të zhvillojë dhe zbatojë një Sistem të Menaxhimit Mjedisor (SMM) në përputhje me parimet e serisë ISO 14000, veçanërisht me kërkesat e ISO 14001.

Sistemi i menaxhimit mjedisor do të mundësonte një qasje të strukturuar për:

- identifikimin e aspekteve dhe ndikimeve mjedisore;
- përcaktimin e objektivave dhe synimeve mjedisore;
- kontrollin e mbetjeve dhe shkarkimeve;
- menaxhimin racional të ujit dhe energjisë;
- kontrollin e konsumit të burimeve;
- parandalimin e incidenteve dhe situatave emergjente;
- trajnimin dhe ndërgjegjësimin e punëtorëve;
- monitorimin dhe dokumentimin e performancës mjedisore;
- ndërmarrjen e masave korrigjuese;
- përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore.

Për aktivitetin e "HAPPY CHICKEN" SH.P.K., zbatimi gradual i një sistemi të tillë do të ishte veçanërisht i dobishëm për menaxhimin e ujit nga puset vetjake, ujërave të ndotura, plehut të shpezëve, gjakut, puplave dhe mbetjeve të tjera organike të thertores, si dhe për kontrollin e aromave dhe përdorimin racional të energjisë.

10. KONKLUZIONE

Në bazë të të dhënave të analizuara në këtë Raport të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, të karakteristikave të lokacionit, gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe mënyrës së funksionimit të aktivitetit, konstatohet se aktiviteti i kompanisë "HAPPY CHICKEN" SH.P.K., që përfshin rritjen e shpezëve, therjen e pulave dhe prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve, mund të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, me kusht që të zbatohen masat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit. Objektet e aktivitetit janë të ndërtuara dhe aktiviteti është në funksionim. Kompleksi përfshin gjashtë ferma për çeljen dhe rritjen e pulave, thertoren dhe hapësirat përcjellëse, si dhe infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e aktivitetit.

Lokacioni shtrihet në parcelat kadastrale P-71813037-00183-0, P-71813037-00184-0 dhe P-71813084-00190-0, në Zonat Kadastrale Korishë dhe Shpenadi, Komuna e Prizrenit, me sipërfaqe

totale prej 27,668.9 m². Lokacioni ka qasje të përshtatshme rrugore dhe ndodhet në zonë me karakter kryesisht bujqësor.

Nga vlerësimi i gjendjes së mjedisit rezulton se ndikimet potenciale të aktivitetit lidhen kryesisht me emetimet e mundshme në ajër dhe aromat, ujërat e ndotura, mbetjet dhe nënproduktet organike të procesit të therjes, plehun e shpezëve, zhurmën dhe rrezikun e ndotjes së tokës dhe ujërave.

Një aspekt i rëndësishëm që kërkon vëmendje të veçantë është fakti se rrjedha e lumit ndodhet afer nga lokacioni, ndërsa furnizimi me ujë i kompanisë bëhet përmes puseve vetjake. Për këtë arsye, duhet të sigurohet mbrojtja e vazhdueshme e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, duke parandaluar çdo shkarkim të pakontrolluar të ujërave të ndotura dhe mbetjeve.

Nga procesi i therjes krijohen mbetje dhe nënprodukte organike, përfshirë gjakun, puplat, pjesët dhe indet organike, yndyrnat dhe mbetje të tjera të procesit teknologjik. Menaxhimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë të kontrolluar, me grumbullim, ruajtje dhe largim të rregullt, në përputhje me kërkesat ligjore dhe përmes subjekteve të autorizuara. Depozitimi i tyre në tokë, në afërsi të lumit ose në hapësira të paautorizuara ndalohet në mënyrë absolute.

Gjithashtu, plehu i shpezëve duhet të menaxhohet në mënyrë të kontrolluar, duke parandaluar rrjedhjet, aromat e pakëndshme dhe ndotjen e tokës apo ujërave.

Me zbatimin e masave të përcaktuara në këtë Raport, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e mbetjeve të thertores, trajtimin dhe kontrollin e ujërave të ndotura, mbrojtjen e puseve, mbrojtjen e lumit, kontrollin e aromave, mirëmbajtjen e sistemeve të ventilimit dhe kanalizimit dhe monitorimin periodik të parametrave mjedisorë, ndikimet negative mund të parandalohen ose të reduktohen në nivel të pranueshëm.

Në bazë të vlerësimit të kryer, nuk janë identifikuar ndikime të tilla të rëndësishme dhe të pakontrollueshme që do ta bënin të papranueshëm zhvillimin e aktivitetit, me kusht që operatori të zbatojë në mënyrë të vazhdueshme masat e përcaktuara në këtë Raport të VNM-së dhe kushtet e Pëlqimit Mjedisor.

Kompania "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. duhet të sigurojë monitorimin e vazhdueshëm, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse, si dhe ndërmarrjen e menjëhershme të masave korrigjuese në rast të ndonjë incidenti ose tejkalimi të parametrave të lejuar.

Duke marrë parasysh këto të dhëna, raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ofron informacion të mjaftueshëm dhe i propozojmë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe

Infrastrukturës (MMPHI) dhënien e një mendimi për Pëlqimin Mjedisor, sipas kërkesës së investitorit-aplikuesit "Happy Chicken" SHPK, me pronar z. Naim Ukaj.

11. BURIMET E TË DHËNAVE - LITERATURA

1. Plani Zhvillimor Komunal i komunës së Prizrenit

3. MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë.

4. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007. Prishtinë.

5. MMPH-AKMM –IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Design House. Prishtinë.

6. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design Prishtinë.

7. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016,

8. MMPH_IHMK – Resurset Ujore te Kosves 2015,

9. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometerologjik 2014,

10. mmph-rks.org/Ligjet 15. Osmani, J. (2008): Vendbanimet e Kosovës.

11. Ligjet dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e raportit të VNM-së

12. SHTOJCA

Bashkëngjitur këtij raporti gjeni:

- Çertifikata e biznesit me veprimtari
- Çertifikatat mbi të drejtat e pronës
- Kopjet e planit
- Kontratat për shfrytëzim të ngastrës
- Situacioni i terenit nga gjeodeti i licencuar
- Inforimi komunal i lëshur nga Komuna e Prizrenit

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE E RAPORTIT TË VNM-së

1. Qëllimi i përmbledhjes

Kjo Përmbledhje Jo Teknike paraqet qëllimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për aktivitetin "Ferma për rritjen e shpezëve, therjen e pulave dhe prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve", të zhvilluar nga "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. në Komunën e Prizrenit.

Raporti ka për qëllim të identifikojë ndikimet potenciale të aktivitetit në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve, si dhe të përcaktojë masat që duhet të ndërmerren për parandalimin, zvogëlimin dhe kontrollin e këtyre ndikimeve. Vlerësimi është bazuar në dokumentacionin teknik, gjendjen faktike të lokacionit, vizitën në terren, të dhënat ekzistuese për mjedisin dhe kërkesat përkatëse ligjore e teknike.

2. Përshkrimi i aktivitetit

Aktiviteti i "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. zhvillohet në ngastrat kadastrale P-71813037-00183-0, P-71813037-00184-0 dhe P-71813084-00190-0, në Zonat Kadastrale Korishë dhe Shpenadi, me sipërfaqe totale prej 27,668.9 m². Në kompleks janë të ndërtuara dhe funksionale gjashtë ferma për çeljen dhe rritjen e pulave, thertorja, hapësirat për përpunimin e mishit, silosët për ruajtjen e ushqimit, objektet teknike dhe ndihmëse, rrugët e brendshme dhe hapësirat për ngarkim-shkarkim.

Procesi teknologjik përfshin çeljen e zogjve, rritjen dhe ushqimin e pulave, transportimin e tyre në thertore, therjen, përpunimin dhe përgatitjen e produkteve të mishit të shpezëve për treg. Ushqimi ruhet në silosët ekzistues dhe aktiviteti zhvillohet në objektet e dedikuara të fermave dhe thertores.

Meqenëse objektet janë tashmë të ndërtuara dhe aktiviteti është në funksionim, Raporti fokusohet kryesisht në ndikimet gjatë fazës së operimit dhe në masat që duhet të zbatohen për funksionim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar.

3. Gjendja e lokacionit dhe mjedisit

Lokacioni ndodhet në një zonë me karakter kryesisht bujqësor dhe rural. Sipërfaqet përreth përdoren kryesisht për kultivimin e kulturave bujqësore sezonale, veçanërisht grurit dhe misrit. Në lokacion janë të pranishme objektet dhe infrastruktura ekzistuese e kompanisë.

Në zonën përreth nuk janë evidentuar burime të mëdha industriale të ndotjes së ajrit. Ndikimet potenciale në ajër lidhen kryesisht me aromat nga fermat dhe menaxhimi i plehut, proceset e thertores, mbetjet organike, silosët dhe qarkullimi i automjeteve.

Një aspekt i rëndësishëm mjedisor është prania e rrjedhës së lumit Toplluga rreth 100 m nga lokacioni. Në të njëjtën kohë, furnizimi me ujë i aktivitetit bëhet përmes puseve vetjake. Për këtë arsye, mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore është konsideruar si një nga çështjet kryesore të menaxhimit mjedisor.

4. Ndikimet kryesore në mjedis

Nga vlerësimi rezulton se ndikimet potenciale të aktivitetit janë kryesisht lokale dhe të menaxhueshme, nëse zbatohen masat e përcaktuara në Raportin e VNM-së. Ndikimet kryesore lidhen me:

- emetimet dhe aromat në ajër;
- përdorimin e ujit;
- krijimin e ujërave të ndotura;
- gjenerimin e mbetjeve dhe nënprodukteve shtazore;
- zhurmën;
- qarkullimin e automjeteve;
- rrezikun nga incidentet dhe situatat emergjente.

Ndikimi në ajër

Burimet kryesore të ndikimit në ajër janë ventilimi i fermave, menaxhimi i plehut të shpezëve, silosët, procesi i therjes dhe përpunimit, mbetjet organike dhe qarkullimi i automjeteve. Menaxhimi jo i duhur i mbetjeve organike mund të shkaktojë aroma të pakëndshme, veçanërisht gjatë periudhave me temperatura të larta.

Ndikimi në ujëra

Ujërat e ndotura krijohen gjatë pastrimit të fermave, procesit të therjes, larjes së pajisjeve, pastrimit dhe dezinfektimit. Ujërat e thertores mund të përmbajnë gjak, yndyrna, proteina, materiale organike, detergjentë dhe dezinfektues dhe për këtë arsye paraqesin ngarkesë të konsiderueshme organike.

Për shkak të afërsisë së lumit Toplluqa dhe përdorimit të puseve vetjake, nuk duhet të lejohet shkarkimi i ujërave të patrajtuara në tokë ose në ujëra sipërfaqësore. Ujërat duhet të mblidhen dhe të trajtohen përmes sistemit përkatës të trajtimit, ndërsa sistemi i kanalizimit duhet të kontrollohet dhe mirëmbahet rregullisht.

Mbetjet dhe nënproduktet e therjes

Një nga aspektet më të rëndësishme të aktivitetit është menaxhimi i nënprodukteve të krijuara në thertore. Këtu përfshihen gjaku, puplat, pjesët dhe indet e papërshtatshme për konsum, përmbajtja e traktit gastrointestinal, yndyrnat dhe mbetjet e tjera organike. Gjithashtu krijohen plehu i shpezëve, shpezë të ngordhura, mbetje komunale dhe ambalazhe.

Këto mbetje duhet të ndahen sipas llojit, të grumbullohen në kushte të kontrolluara, të ruhen përkohësisht në mënyrë të sigurt dhe të dorëzohen për trajtim ose largim përmes operatorëve të autorizuar, sipas kategorisë së mbetjes.

Toka

Rreziku kryesor për tokën lidhet me menaxhimin jo të duhur të mbetjeve organike, plehut të shpezëve, ujërave të ndotura dhe substancave të përdorura për pastrim e dezinfektim. Për këtë arsye, mbetjet nuk duhet të depozitohen drejtpërdrejt në tokë, ndërsa duhet të parandalohet çdo rrjedhje e ujërave të ndotura jashtë sistemit të kanalizimit.

Zhurma

Zhurma krijohet kryesisht nga ventilatorët, pajisjet e fermave dhe thertores, kompresorët, sistemet e ftohjes dhe automjetet. Mirëmbajtja e pajisjeve, izolimi i burimeve me zhurmë të lartë dhe organizimi i duhur i transportit dhe ngarkim-shkarkimit do të kontribuojnë në kufizimin e këtij ndikimi.

5. Masat për mbrojtjen e mjedisit

Raporti përcakton masa teknike dhe organizative për kontrollin e ndikimeve. Masat kryesore përfshijnë:

- mirëmbajtjen dhe pastrimin e rregullt të fermave dhe thertores;
- ventilimin e përshtatshëm të objekteve;

- menaxhimin e kontrolluar të plehut dhe nënprodukteve të therjes;
- mbledhjen e veçantë të gjakut, puplave dhe mbetjeve të tjera organike;
- grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura;
- mbrojtjen e tokës dhe ujërave nëntokësore;
- mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit;
- përdorimin racional të ujit dhe energjisë;
- kontrollin dhe reduktimin e zhurmës;
- mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve teknike;
- zbatimin e procedurave për raste aksidentale dhe emergjente.

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e këtyre masave i takon operatorit "HAPPY CHICKEN" SH.P.K., i cili duhet të caktojë person përgjegjës për çështjet mjedisore, menaxhimin e mbetjeve, ujërave të ndotura, monitorimin dhe raportimin.

6. Monitorimi mjedisor

Programi i monitorimit synon të kontrollojë ndikimet e aktivitetit dhe të verifikojë zbatimin e masave të përcaktuara në Raportin e VNM-së.

Monitorimi duhet të përfshijë veçanërisht:

- cilësinë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura;
- cilësinë e ujit nga puset vetjake;
- menaxhimin e gjakut, puplave dhe mbetjeve organike;
- menaxhimin e plehut të shpezëve;
- aromat dhe emetimet në ajër;
- zhurmën;
- gjendjen e tokës;
- ndikimet e mundshme në lumin Toplluqa;
- zbatimin e masave mjedisore.

Matjet laboratorike duhet të kryhen nga laboratorë ose subjekte të autorizuara, ndërsa të dhënat duhet të dokumentohen dhe të ruhen në mënyrë të rregullt.

7. Alternativa e projektit

Meqenëse aktiviteti është ekzistues dhe objektet janë tashmë të ndërtuara, janë shqyrtuar alternativa e vazhdimit të aktivitetit në lokacionin ekzistues, përmirësimi i masave teknologjike dhe mjedisore dhe alternativa "pa veprim".

Alternativa e preferuar është vazhdimi i aktivitetit në lokacionin ekzistues, i shoqëruar me zbatimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit. Kjo vlerësohet si alternativa më e arsyeshme pasi objektet dhe infrastruktura ekzistojnë, lokacioni ka qasje të përshtatshme dhe ndikimet mjedisore mund të kontrollohen përmes masave teknike dhe organizative.

8. Menaxhimi mjedisor

Operatori duhet të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të masave mjedisore dhe pajtueshmërinë me Pëlqimin Mjedisor dhe kërkesat ligjore në fuqi. Gjithashtu rekomandohet zhvillimi gradual i një Sistemi të Menaxhimit Mjedisor sipas ISO 14001, i cili do të ndihmonte në kontrollin e ujit, energjisë, mbetjeve, ujërave të ndotura, aromave dhe ndikimeve të tjera mjedisore.

9. Përfundimi

Në bazë të vlerësimit të kryer, aktiviteti i "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. për rritjen e shpezëve, therjen e pulave dhe prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve mund të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, me kusht që të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme masat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit.

Ndikimet e identifikuara vlerësohen kryesisht si lokale dhe të menaxhueshme. Nuk janë identifikuar ndikime të tilla të rëndësishme dhe të pakontrollueshme që do ta bënin aktivitetin të papranueshëm nga aspekti mjedisor, nëse operatori zbaton masat e VNM-së, monitoron parametrat mjedisorë dhe ndërmerr masa korrigjuese në rast të incidenteve ose tejkalimit të parametrave të lejuar.

Në veçanti, prioritet duhet t'i kushtohet mbrojtjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, duke marrë parasysh afërsinë e lumit Toplluqa dhe përdorimin e puseve vetjake, si dhe menaxhimit të sigurt të gjakut, puplave, plehut dhe mbetjeve të tjera organike të krijuara nga aktiviteti i fermave dhe thertores.